Biblioletra

REVISTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

VITI 8 • NUMRI 3 • 2011

ZHVILLIMI I KOLEKSIONEVE PËR BIBLIOTEKËN DIGJITALE KOMBËTARE TË KOSOVËS: PRITSHMËRITË E PËRDORUESVE

Besim Jakup KOKOLLARI

HYRJE

Bibliotekat digjitale paraqesin zhvillimet më të fundit bibliotekare në fushën e konkurrencës sa të domosdoshme aq edhe të natyrshme të institucioneve bibliotekare karshi trendëve elektronikë të informacionit të ofruara përmes internetit. Si duket, zhvillimi i teknologjive të reja të informacionit e krahas tyre edhe ndryshimi i sjelljes së faktorit njeri sesi e shfrytëzojnë informacionin, ndihmon në zhvillimin dhe shpikjen e mënyrave të reja të ofrimit të shërbimeve të informacionit. Jo rrallë jemi mësuar të dëgjojmë dhe t'i konsiderojmë shërbimet elektronike të bibliotekave, apo përpjekjet e tyre në këtë drejtim, si konkurrente me botën e internetit. Ashtu edhe e filluam këtë punim me shprehjen "konkurrencë e natyrshme" në kuptimin e asaj se sot është krejtësisht e natyrshme të jemi konkurrentë në një botë të trendëve globale ku mbizotëron tregtia, bollëku i njëllojshmërisë së ofruar nga tregtia masive mes të cilës përpëlitet e veçanta, unikja, dhe e pazëvendësueshmja.

/VIJON NË FAQE 12/

PERSPEKTIVAT KOMBËTARE NË INTEGRIMET BOTËRORE

(REZOLUTA E EDICIONIT VI TË KONFERENCËS KOMBËTARE TË BIBLIOTEKONOMISË)

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë, si institucion kulturor-shkencor i përbashkët Shqipëri - Kosovë, mbajti më 18 – 19 nëntor 2011, edicionin VI të saj nën temën "*Perspektivat kombëtare në integrimet botërore*".

Konferenca u organizua në mjediset e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në Prishtinë. Ajo u ndoq nga menaxherë e specialistë të shkencës së bibliotekonomisë të bibliotekave kombëtare, universitare, publike, nga të dy vendet .

Bazuar në gjendjen konkrete të bibliotekave dhe në problemet që u trajtuan në Konferencë, pjesëmarrësit e miratuan rezolutën e mëposhtme:

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës i realizojnë detyrat e tyre funksionale duke mbajtur parasysh ngaherë rolin përcaktues që ato kanë në epokën digjitale, mbështetur në legjislacionet përkatëse për bibliotekat në të dyja vendet, duke respektuar dhe zbatuar standardet bibliotekare ndërkombëtare. Në mjedisin e ri digjital, roli i të dy bibliotekave kombëtare në zbatim të këtyre detyrave është që të mundësojnë qasje në informacion për të gjithë përdoruesit, kudo e në çdo kohë.

Konferenca u rekomandon të dy bibliotekave partnere, BKUK dhe BKSh, të theksojnë si përparësi integrimin biblio-webografik të tyre në portalet e përbashkëta europiane (EUROPEANA) dhe botërore (World Digital Library), si dhe t'i shmangen humbjes së energjisë dhe potencialeve në kinse integrime, që u largohen këtyre përparësive.

Të vetëdijshëm se, të dy bibliotekat kombëtare, ajo e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës, kanë një rol të veçantë në ndërtimin dhe përditësimin e vijueshëm të Portalit Albanologjik Shqipëri -Kosovë (www. portalialbanologjik.net), paraqitet nevoja e bashkëpunimit të të dy institucioneve, në mënyrë që të realizohet integrimi i informacionit mbi trashëgiminë e kulturës së shkruar mbarëshqiptare në rrjetin europian dhe botëror të informacionit.

Konferenca ka besim se Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës do të ngrenë në një nivel më të lartë angazhimin për plotësimin si duhet të detyrave funksionale në këtë sipërmarrje të rëndësishme duke përmbushur kështu misionin e tyre të çmuar kombëtar dhe kulturor.

Prishtinë, 19 nëntor 2011

Në këtë numër

NGA BIBLIOGRAFIA TE WEBOGRAFIA: MUNDËSI APO REALITET PËR BIBLIOTEKAT SHQIPTARE 3

LIBRI DHE BIBLIOTEKAT.....6

55 VJET TË LIBRIT SHQIP NË KOSOVË.....8

KUR LIGJI OBLIGON, PATJETËR DUHET ZBATIM 10

Click here: www.portalialbanologjik.net 19

REFERENCA BIBLIOGRAFIKE NË FORMË TË ARTIKULLIT 21

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota
Kryeredaktor: Fazli Gajraku
Këshilli redaktues: Bukurije Haliti, Izet Abdyli, Muharrem Halili, Bedrije Mekolli
Fotograf: Bujar Mehmeti; **Realizimi kompjuterik:** Hekuran Rexhepi
Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë
Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

NGA BIBLIOGRAFIA TE WEBOGRAFIA: MUNDËSI APO REALITET PËR BIBLIOTEKAT SHQIPTARE

"So where is the agora for the global community?
The answer has to be, on the net"
Brenda Laurel[1]

Dr. Etleva DOMI

EPOKA DIGJITALE

Punimet e kësaj konference po zhvillohen në një kohë, kur si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, flitet gjithnjë e më shumë për procese integrimesh e globalizimesh, kur diskutohet për përqasje në burime digjitale ose bibliografike, kur bëhen përpjekje për krijime portalesh, kur mbarë bota është ka ndërmarrë nga nisma e projekte për përfshirje në rrjetin global jo vetëm të bibliotekave, por edhe të muzeumeve dhe të arkivave.

Panorama e impakteve (efekteve, ndikimeve) të globalizimit në institucionet bibliotekare sa vjen e bëhet më e dukshme, më e prekshme, më e qartë. Transformimi i bibliotekave, të perceptuara tradicionalisht si "fole" konservatore të kujtesës dhe trashëgimisë, në qendra flexible informacioni në të ardhmen, do të mund të sigurohej vetëm, nëse procesi i globalizimit gjykohet, vlerësohet me mendjekthjelltësi.

Shtrirja e Internetit, - këtij rrjet kompjuterik gjigand, - në mbarë botën, po u ofron internetistëve një gamë gjithnjë e më të gjerë informacioni, çfarë po mundësohet me krijimin e vijueshëm të portaleve europiane dhe/ose globale, me weblinke dhe burimeve bibliografike të pafundme. Revolucioni kompjuterik, - pjesë e pandashme e bibliotekave në epokën digjitale, - zhvillimi marramendës i teknologjive të informacionit, kanë çuar tanimë në një kuptim të ri të rolit bashkëkohor të bibliotekës në shoqërinë moderne.

Është paradoksale që teknologjia e informacionit, që i jep qasje shërbimeve në biblioteka, t'i çojë disa në pyetje të tilla si: "A do të vijojnë që jenë të nevojshme bibliotekat për të përgatitur bibliografitë kombëtare?", " Si do të jetë e ardhmja e grafisë së librit përballë evolucionit virtual?", "Si do të jetë e ardhmja e bibliografëve?", "A do të thithen bibliografët nga hypertekset?" etj. etj.

Dhe në këto kushte, bibliotekarët, si pjesëtarë në lëvizjen drejt një infrastrukture të informacionit digjital, duhet të kujtojnë Michael Gorman-in, i cili në ditët tona ka riformuar, 5 ligjet e bibliotekonomisë të Ranganatan-it, të formuluara prej tij në vitin 1932. Sipas tij bibliotekat:

1. I shërbejnë njerëzimit;
2. Respektojnë të gjitha format që mundësojnë komunikimin e dijes;
3. Përdorin teknologjitë në mënyrë inteligjente për të shtuar shërbimet;
4. Ruajnë qasjen e lirë në dije;
5. Respektojnë të shkuarën dhe krijojnë të ardhmen.

Prej nesh, komunitetit të bibliografëve, është mëse i njohur fakti, që zgjerimi i rrjetit botëror të komunikimit, - World Wide Web-it, - që prej zanafillës së tij në vitin 1993, bëri që të lindte nevoja e formave të reja për citimet në bibliografi, në lista referimesh dhe tekste të ngjashme me to. Problemet që shtrohen sot, nuk kanë të bëjnë vetëm me format e citimit, por edhe të përmbajtjes dhe teknikës së prodhimit të tyre.

II. BIBLIOGRAFIA KOMBËTARE

Mijëvjeçari i ri, parë në një këndvështrim global, lajmëron fundin e periudhës së zhvillimit shoqëror, identifikuar si shoqëri civile, dhe në të njëjtën kohë shënon fillimin e një epoke të re, atë të shoqërisë së informacionit. Kjo, nuk kushtëzohet vetëm nga zhvillimi intensiv teknologjik, por edhe nga rëndësia e qasjes së lirë në dije dhe informacion për të tërë qytetarët në mbarë botën.

Është e rëndësishme të kuptohet që sot, bibliotekat kombëtare, që tradicionalisht kanë grumbulluar dhe ruajtur informacion, në shek. XXI, roli i tyre më i rëndësishëm është të prodhojnë informacion, burimet e informacionit t'i bëjnë të përdorshme nga të gjithë përdoruesit, të ruajnë koleksionin universal të dijes, përfshirë edhe atë digjital, edhe për brezat e ardhshëm. Në shekullin e 21-të teknologjia e demokratizoi informacionin.

Dhe bibliotekat kombëtare, si hambarë të dijes, ku si qytetari i thjeshtë, ashtu edhe intelektuali, vjen për të shuar etjen për dije, kanë një rol të rëndësishëm në orientimin e frekuentuesve në labirintin e ndërlikuar të burimeve digjitale. Teknologjitë e reja të informacionit nuk e zbehin aspak rëndësinë e misionit të bibliotekave. Si pjesëtarë në rrjetin botëror të informacionit, bibliotekat po luajnë jo vetëm rolin e mediatorëve teknikë, por dhe të dialoguesit me përdoruesit.

Siç dihet tanimë nga të gjithë, Interneti po rritet me një shpejtësi marramendëse dhe website-t e tij po ofrojnë gjithnjë e më shumë një mizëri informacioni për gjithçka, qasje të barabartë për këdo, në çdo vend e në çdo kohë. Historikisht, duke qenë burimi kryesor i informacionit në shekuj, bibliotekat mund të konsiderohen si një ndër prototipet kryesore, ikona e Internetit modern, që ngjason (është pak a shumë e ngjashme me idenë) me bibliotekën e Babilonit e tregimit të famshëm të Borgesit.

[1] Interval Research Cooperation, quoted in Leslie, 1993, p.34

Në epokën e kibernetikës, bibliografia kombëtare, në formë tradicionale (letër) ose elektronike (nëlinjë/online), është një nga portat e hyrjes në bibliotekën digjitale. Dhe janë pikërisht bibliografët, të cilët, pasi kanë listuar, përshkruar, regjistruar në vite shtypshkrime të llojeve të ndryshme, pasi iu kanë mundësuar përdoruesve informim dhe orientim, pasi i kanë lehtësuar studiuesit në kërkimet e tyre duke iu ofruar aparatin e larmishëm të indekseve, - që internetistët i quajnë tanimë "motorë kërkimi", në mjedisin virtual, duhet me doemos të mundësojnë edhe qasjen në to.

Për këtë arsye, në mjedisin e informacionit digjital, agjencitë kombëtare bibliografike renditen si ndër më kryesoret në vargun e pafundmë të strukturave, që ofrojnë informacion bibliografik. Bibliografitë kombëtare janë kujtesa e një kombi; ato ngaherë kanë shërbyer për "të identifikuar, verifikuar, lokalizuar" kërkimin bibliografik. Në "superstradën" aktuale të informacionit, vetëm nëpërmjet ngritjes së sistemeve të përbashkëta të marrje - dhënies së informacionit nëpërmjet Internetit dhe strukturës kombëtare të informacionit, elementët e nevojshëm të një "biblioteka pa mure" ("library without walls") do të mund tanimë të vendoseshin.

Bibliografitë Kombëtare, si në Shqipëri, ashtu dhe në Kosovë, të cilat përfshijnë botimet e shtypshkruara, siguruar nëpërmjet ekzemplarit të detyruar sipas legjislacioneve përkatëse, ende botohen vetëm në formën tradicionale (në letër); ndërkohë, që në botën digjitale, bibliotekat kombëtare, bibliografitë e tyre duhen t'i kenë të konsultueshme edhe në websitet-et e tyre, duke mundësuar kështu një informacion të saktë e të shpejtë për botimet më të fundme të vendeve të tyre. Madje, edhe Shtetet e Bashkuara, ndonëse nuk kanë zyrtarisht një bibliografi kombëtare amerikane, duke vlerësuar rëndësinë e qasjes edhe nëlinjë/online të informacionit bibliografik kombëtar, kanë autorizuar Library of Congress për përgatitjen e katalogut përmbledhës kombëtar, që të mund të luajë këtë rol; katalogu daton që prej viti 1876.

Bibliografia Kombëtare është dije e organizuar, e cila ngahera i ka orientuar përdoruesit e saj. Ajo jep informacion bibliografik të lokalizuar (të një vendi të caktuar), në një kohë të caktuar (brenda një periudhe të caktuar), të përimtuar (me mori indeksesh, që ndihmojnë të mos humbasësh duke kërkuar nëpër site të pafundme), çfarë ndikojnë ndjeshëm në efikasitetin e proceseve kërkimoreshkencore. Një kthim i shpejtë në shpikjen e Gutenbergut është ndriçues. Shtypshkronja nuk përhapi vetëm shumë njohuri/dije, por ajo solli gjithashtu edhe shpikjen e pasqyrës së lëndës dhe indekseve të emrave të personave, vendeve dhe tematike: progres thelbësor në krahasim me çfarë ofronin më parë doreshkrimet.

Vlen të përmendim faktin që, ndonëse sot, në botën virtuale, referimet bibliografike, realizuar nga webografët, janë të panumërta në tregun oqeanik bibliografik, kur materiali i kërkuar nuk mund të gjendet, sidomos ai jokorrent, çdokush është i detyruar t'i drejtohet bibliografive kombëtare. Avantazhi i tyre është që ato listojnë gjithçka që është botuar, botimet i kanë të renditura dhe të mirëorganizuara; përshkrimi bibliografik mbështetet në standarde; ndihmojnë në verifikimin e informacionit bibliografik; ofrojnë indekse të llojeve të ndryshme etj. Edhe në raport me katalogët e bibliotekave, manualë ose nëlinjë/online, të cilët pasqyrojnë tërësinë e dokumenteve që gjenden në një bibliotekë, ose libraritë virtuale, që listojnë botimet e tyre, bibliografitë kombëtare ngahera do të shërbejnë si udhërrëfyes të saktë, të shpejtë, efikas në kohë në shërbim të përdoruesve dhe/ose internetistëve.

Edhe me zhvillimin e bazës së të dhënave dhe burimeve referuese në Internet, përdorimin gjithnjë e më shumë të teknologjive të reja, bibliografia do të vijojë të jetë, pavarësisht nga teknika e prodhimit (në letër, CD, mikrofilm, nëlinjë/online etj.) një ndër burimet më të rëndësishme të informacionit për produktin intelektual të një kombi. Ajo çfarë justifikon vijimin e botimit të bibliografive kombëtare, është përjetësia e informacionit që ajo përmban. Edhe në epokën virtuale, ajo nuk duhet të jetë vetëm misionare e ruajtjes së trashëgimisë, që e ka kryer që prej krijimit, por dhe misionare e shërbimit në distancë të përdoruesve, të pritur prej vitesh.

III. WEBOGRAFIA

Tani, gjashtë shekuj larg nga shpikja e Gutenbergut, në epokën e kibernetikës dhe internetit, ndeshemi jo rrallë me terma e koncepte të reja, - ende të panjohura e të papërdorura në jetën e përditshme, - një pjesë e të cilave të papërfshira në fjalorët dhe/ose enciklopeditë botërore.

Që prej marsit të vitit 1989, kur fizikani anglez Tim Berners-Lee, parashtroi çfarë do të ishte (become) World Wide Web-i, i ndjekur më pas, nga specialisti i kompjuterëve belgu Robert Cailliau, kohë, kur së toku, në vitin 1990, arritën në përfundimin që ai është një "HiperText [...] që lidh dhe mundëson qasjen në informacion të larmishëm si një web nyjesh, në të cilin përdoruesi mund të navigojë duke "kullotur" plot endje, një numër i madh njerëzish prej të gjithë kontinenteve dhe të gjithë horizonteve kulturore, vijojnë të debatojnë për përkufizimet e termave të lindura në epokën digjital. Ka edhe nga ata, që ende debatojnë për terma si: "Internet" dhe "Word Wide Web", kur është konsoliduar tanimë përkufizimi i "Internetit" si "sistem i përbotshëm i rrjeteve të ndërlidhura kompjuterikë" dhe "Web-i, si një ndër shërbimet që funksionon në Internet, por është vetëm një pjesë e vogël e tij".

Ndërkohë që, sa herë komuniteti i bibliografëve mblidhet nëpër konferenca, seminare, forume profesionale etj., në kumtimet e diskutimet e tyre nuk lenë pa përmendur personalitete si: Gabriel Naudé (i pari që përdori termin bibliografi në botimin e tij: *Bibliographia politica,* 1633), P. Jacob (themeluesi i

bibliografisë kombëtare moderne), të cilët do të mbeten gurët e themelit të shkencës së bibliografisë, kur çdokush prej tyre e di tashmë si etimologjinë ashtu edhe rrugën e gjatë të konsolidimit të përkufizimit "bibliografi", në mjaft vende, jo shumë nga po i njëjti komunitet, kuptojnë, diskutojnë, përdorin në masë termin "webografi" dhe "webograf".

Historia e librit dhe e bibliografisë na mëson që termi "bibliografi" vjen nga greqishtja "Biblion" = livre dhe "graphein" = écrire; që në formë të shtypshkruar bibliografia u shfaq në vitin 1494, pak vite pas zbulimit të tipografisë, ndërkohë që në formë dorëshkrimi shumë kohë më parë; që terminologjia e saj ka kaluar një udhë të gjatë: nga "listë veprash" (mjeku grek Claude Galien, shek II) në "repertor titujsh" (1494), për të vijuar më tej te: bibliotheca, catalogus, repertorium, inventarium, index; që u desh kohë që të bibliografia të konsiderohej si disiplinë më vete; që u deshën vite që përpjekjet e historianëve, bibliografëve, arkivistëve, paleografëve si: Charles Mortet (1896), Charles-Victor Langois (1863-1929), Georg Schneider (1926) etj. për të përkufizuar termin bibliografi, të finalizoheshin me miratimin nga UNESCO- ja në nëntor të 1950, vit që ka standardizuar përkufizimin e termit si në fjalorë, enciklopedi, tekste ashtu edhe në burimet nëlinjë/online si: "një listë e strukturuar dokumentesh, sidomos artikujsh, që kanë karakteristika të përbashkëta, për një objekt të caktuar" dhe nga bibliotekarët si " tërësia e teknikave të përshkrimit të dokumentit dhe kërkimit dokumentar".

Ekzistenca e suporteve të tjerë të komunikimit, mbështetur në të njëjtin model, ka sjellë edhe lindjen e termave të tillë si: filmografi, diskografi, webografi.

Ndërsa historia e Internetit dhe e botës digjitale na mëson që vendlindja e termit "webografi" ose "webliography" (1995) është po Amerika, që është vendlindja e botës digjitale. Shpjegimi i tij gjendet për herë të parë në Oxford English Dictionary (Fjalorin e Oxfordit) në vitin 1995. Ashtu si për "Bibliotekën digjitale", edhe për "webografinë", në punën tonë të përditshme, ndeshemi me përkufizime të ndryshme si: "listë website-sh që lidhet me një çështje (problematikë) të caktuar; është tepër e ngjashme me bibliografinë, por kufizohet më shumë në një koleksion të burimeve në linjë/online sesa librat dhe revistat akademike; studiuesit e drejtojnë krahasimin me bibliografinë tradicionale" (Wikipedia), "listë burimesh digjitale për një çështje apo subjekt specifik" (Online Dictionnary for library and Information Science), "listë punimesh ose dokumentesh elektronike, sidomos website me linke hypertekstesh, që lidhen sidomos me një çështje të caktuar" (American website).

Le të na shërbejë webografia, ky potencial që na ofron sot bota elektronike, si shtysë për të ideuar mundësi për krijime portalesh a rrjetesh të përbashkëta bibliografike, "autostradash" informatike, zhvillime spektakolare të website-ve tona.

E ARDHMJA: RRJETI SHQIPTAR BIBLIOGRAFIK NË LINJË/ONLINE

Në një kohë kur, autostrada Durrës-Kukës-Morinë, mundësoi integrimin e Shqipërisë në sistemin europian të komunikacionit, bibliotekave tona i është hapur një rruge, me anë të të cilës, na jepet mundësia për t'u lidhur me autostradat tona virtuale të komunikimit.

Në epokën e konkurrencës teknologjike, kur përditë flitet e shpresohet për integrime në rrjedhat europiane e botërore, a nuk duhet që edhe bibliotekat tona kombëtare të shtyhen për të ngritur rrjete të përbashkëta informacioni bibliografik? Them se po. Ka ardhur koha që të përpilojmë strategjitë tona për një rrjet shqiptar bibliografik nëlinjë/online.

Integrimi dhe globalizimi provojnë bindshëm që e ardhmja e bibliotekave do të jetë frytdhënëse, vetëm nëse ato bëhen pjesë e rrjetit global bibliotekar. Nëse një bibliotekë vendos nëlinjë/online katalogët elektronikë, bibliografitë, bazat e ndryshme të të dhënave etj., atëherë ajo mundëson qasje në burimet e saj, i bën ato të shfrytëzueshëm nga çdo kompjuter, nga çdokush, nga kudo.

Kujtojmë thënien e filozofit grek Demosten që "Mundësitë e vogla janë shpesh fillimi i nismave të mëdha". Tani, në shekullin XXI, 2000 vjet më vonë, ne ende përpiqemi të shfrytëzojmë "mundësitë e vogla" për të ndërtuar ndërmarrjen e madhe të përdorimit të dijes së përbashkët të njerëzimit. Prandaj, këtë përpjekje, do ta konsideroja si fillimin e nismës së madhe për të përdorur gjithnjë e më shumë teknologjitë e reja në të gjithë sistemin bibliotekar, në mënyrë që, të ndërtojmë fillimisht ndërmarrjen e madhe - që është rrjeti shqiptar bibliografik nëlinjë/online dhe, më vonë, themelet e bibliotekës digjitale shqiptare.

Një projekt i tillë ambicioz është plotësisht në përputhje si me politikat e qeverisjeve aktuale, me programet për integrime të Shqipërisë dhe Kosovës në rrjetet globale të informacionit, përdorimin e teknologjive të reja në dobi të individëve dhe gjithë shoqërisë shqiptare, ashtu edhe me rekomandimet e Bashkimit Europian.

Shpreh bindjen, se komuniteti i bibliografëve në Kosovë dhe Shqipëri, gjatë këtyre dy ditëve të punimeve, me referimet dhe diskutime e tyre, do të ideojnë në këtë Konferencë strategjinë që shtron sot epoka digjitale, dhe në përmbyllje të saj, të gjithë së toku, do të propozojmë hartimin e një platforme model për krijimin i një rrjeti të përbashkët bibliografik shqiptar online.

Preferoj ta përfundoj me: "Nuk ka asgjë të përhershme përveçse ndryshimit" (Heraclitius). I gjithë komuniteti i bibliotekarëve e di që ndryshimet e vijueshme janë karakteristike për kohën në të cilën ne jetojmë. Sfida të papritura mund të shfaqen përpara nesh në të ardhmen. Por, unë jam optimiste sepse efektet e punës së kryer nga bibliotekarët, në mbarë botën, janë afatgjate, duan kohë që të duken. Nuk është edhe aq e lehtë të maten sukseset. Historia vijon.

LIBRI DHE BIBLIOTEKAT

Prof.dr. Sali BASHOTA

Sipas burimeve të ndryshme, historiku i bibliotekave në Kosovë daton nga periudha të hershme, madje që nga shekujt XIV-XV. Funksioni i këtyre bibliotekave ndërlidhet kryesisht me misionin e bashkësive të kultit. Por, nga ana tjetër, veprimtaria botuese në Kosovë dëshmohet në një kohë krejt të re, megjithëqë është për të besuar se bashkësitë e kultit, paralelisht me përdorimin e librit, do ta kenë kultivuar edhe prodhimin e tij.

VEPRIMTARIA BOTUESE

Veprimtaria botuese në gjuhën shqipe në Kosovë ka filluar në vitet '40 të shekullit XX. Që nga viti 1943 fillojnë të botohen broshura të ndryshme në gjuhën shqipe. Libri i parë i leximit botohet në vitin 1945, ndërsa *Abetarja* e parë në vitin 1946. Në vitin 1950 themelohet Shtëpia Botuese *Mustafa Bakija*, e cila në fillim të veprimtarisë së saj botonte vepra të përkthyera e pastaj edhe vepra origjinale. Në këtë periudhë fillojnë të botohen vepra të autorëve të Kosovës, ndërsa nxitja, përkrahja dhe afirmimi i krijuesve përqendrohet sidomos pas themelimit të revistës letrare *Jeta e re* në vitin 1949. Kjo revistë kishte rol të rëndësishëm në përkrahjen e krijuesve dhe në zhvillimin e përgjithshëm të letërsisë dhe kulturës në Kosovë.

Aktiviteti i Shtëpisë Botuese *Mustafa Bakija* integrohet në vitin 1956 në kuadër të shtypshkronjës *Miladin Popoviqi*, ndërsa në vitin 1958 Ndërmarrja Botuese Grafike *Rilindja*, me veprimtarinë e saj të gjithanshme në shumë fusha bëhet botuesi kryesor i veprave të përkthyera dhe i veprave origjinale.

Veprimtaria botuese e teksteve shkollore zhvillohej fillimisht nga Enti për Botimin e Teksteve Shkollore i RS të Serbisë, reparti në Kosovë, pastaj u përqendrua tek Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, që është themeluar në vitin 1970, përkatësisht Shtëpia Botuese e tanishme *Libri shkollor*. Prej vitit 1962 deri në vitin 1969, si paralele e ndarë e Entit të Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të Serbisë, ishin botuar 464 tituj të teksteve shkollore, ndërsa në edicionin e këtij botuesi në periudhën ndërmjet viteve 1970 - 1979 u botuan 492 tituj të teksteve shkollore. Në periudhën e viteve 1980-1989 ishin botuar 831 tituj të teksteve shkollore për arsimim fillor dhe të mesëm. Prej vitit 1992 deri në vitin 2001 u botuan 370 tituj të teksteve shkollore. Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, përkatësisht *Libri shkollor* që nga viti 1992 deri në vitin 2006 i ka botuar rreth 500 tituj të teksteve mësimore të të gjitha niveleve, duke përfshirë edhe lektyrën shkollore.

Në vitin 1943 broshurat e para u botuan në tirazh 200 ekzemplarë, ndërsa *Abetarja* e parë u botua me një tirazh 66.500 ekzemplarë. Vetëm në vitin 1955 u botuan 64 tituj veprash të reja.

Redaksia e botimeve *Rilindja*, e cila botoi mbi 2000 vepra të autorëve shqiptarë, i ka afirmuar vlerat kulturore, shkencore e letrare jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Shifra dhe fakte dëshmojnë se deri në vitin 1974 u botuan 1073 tituj, ndërsa deri në vitin 1984 u botuan 3200 tituj. Para ndërhyrjes së masave të dhunshme deri vitin 1989, *Rilindja* i kishte botuar mbi 3800 tituj veprash të ndryshme.

Në aktivitetin botues të *Rilindjes*, e cila çdo vit botoi nga 120 tituj të rinj, është mbështetur krijimtaria origjinale e autorëve bashkëkohorë, botimi i veprave komplete, botimi i veprave të autorëve të traditës, si dhe veprat e përkthyera. *Rilindja* u bë njëri ndër botuesit më të mëdhenj në rajon, madje edhe me tirazhin e veprave të botuara, duke e afirmuar kulturën dhe letërsinë shqipe në panairet kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga vëllimi i madh i botimeve në këtë periudhë, në vitin 1985 Kosova kishte një libër për kokë të banorit.

Në vitin 1989 *Rilindja* botoi 80 tituj, ndërsa në periudhën e viteve 1990-1999 çdo vit u botuan mesatarisht nga 30-40 tituj. Këtë periudhë e karakterizon deinstitucionalizimi i kulturës shqiptare, domethënë rrënimi dhe okupimi i saj, si dhe paralizimi i botimeve në gjuhën shqipe nga pushteti i Serbisë në Kosovë.

Veprimtarinë botuese me karakter hulumtues dhe shkencor e kanë zhvilluar dhe e zhvillojnë edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, e cila nga viti 1976 deri në vitin 2008 ka botuar mbi 200 tituj veprash të ndryshme nga fusha e gjuhësisë, letërsisë, shkencave shoqërore, shkencave të natyrës, arteve, duke përfshirë edhe botime kolektive dhe revista të përkohshme. Instituti Albanologjik i Prishtinës, ndërkaq, prej fillimit të veprimtarisë botuese e deri në vitin 2008 ka nxjerrë 400 botime nga fushat e albanologjisë: gjuhësi, letërsi, folklor, histori dhe etnologji.

Edhe institucionet e tjera arsimore, shkencore, kulturore, siç janë: Universiteti i Prishtinës, Arkivi i Kosovës, Instituti i Historisë, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës e kanë zhvilluar dhe vazhdojnë me veprimtarinë botuese në fushat e tyre hulumtuese, shkencore dhe profesionale.

Në Kosovë, pos *Rilindjes*, e cila ndodhej në situatë të pafavorshme për të ushtruar funksionin e saj, në vitin 1990 veprimtarinë e pavarur botuese e fillon shtëpia botuese private *Buzuku*, ndërsa në vitin 1994 *Dukagjini*. Pas viteve 1999 edhe shtëpitë botuese *Faik Konica*, *Rozafa*, *Shpresa* dhe botues të tjerë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e botimeve. Shtëpia botuese *Dukagjini*, pas viteve 1999 fillon të botojë edhe literaturë shkollore.

Veprimtaria botuese në Kosovë është zhvilluar edhe në institucione të tjera shoqërore dhe private në shumë komuna të Kosovës.

Gjatë periudhës së RSFJ-së në Kosovë ka pasur botime në gjuhën serbokroate, për çka është kujdesur shtëpia botuese *Jedinstvo*, dhe në gjuhën turke, për çka është kujdesur *Tan-i.*

VEPRIMTARIA BIBLIOTEKARE

Në Kosovë funksionon rrjeti bibliotekar i këtyre bibliotekave: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e

Kosovës, bibliotekat ndërkomunale, komunale, universitare, speciale dhe shkollore.

Në vitin 1944 në Prizren është themeluar institucioni i parë bibliotekar në Kosovë. Prandaj, themelimi dhe zhvillimi i bibliotekave në Kosovë e ka pikë referimi Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, e cila ka kaluar nëpër disa faza, madje duke marrë emërtime të ndryshme: Biblioteka Regjionale e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë (1944-1952), Qendra Bibliotekare e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë (1956-1961), Biblioteka Popullore Krahinore (1961-1970), Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës (1970-1990), Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës e Metohisë (1990-1999), ndërsa nga viti 1999 – Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

Ndërtesa e tanishme e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës u inaugurua më 25 nëntor 1982. Hapësira e saj përfshin 16.500 metra katrorë. Është e përbërë me dritare zenitale, me gjithsej 99 kupola, të cilat e kanë simbolikën e vet të veçantë arkitekturale.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është institucioni bibliotekar qendror i Kosovës dhe qendër e informacionit bibliotekar në nivel kombëtar. Aktiviteti i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës është i ngjashëm me bibliotekat e tjera kombëtare në shtete të ndryshme të botës dhe ajo është anëtare në asociacione të ndryshme ndërkombëtare.

Me rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës në vitin 1989, veprimtaria bibliotekare, sikundër edhe në sferat e tjera në kulturë, arsim e shkencë, u diskriminua nga pushteti serb.

Periudha e viteve 1998-1999 është periudha e okupimit dhe e inkuizicionit, pra e shkatërrimit, zhdukjes dhe e djegies së koleksioneve bibliotekare në shumë biblioteka publike dhe private në Kosovë.

Nga viti 1990 e deri në vitin 1999 në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës pushteti serb aplikoi masat e dhunshme duke u mohuar lexuesve shqiptarë të drejtën për shërbime. Pos që ishte mbushur me refugjatë serbë nga Kroacia dhe Bosnja, në periudhën mars-maj 1999, gjatë ndërhyrjes së NATO-s, ndërtesa e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës ishte edhe bazë e ushtrisë serbe.

Në periudhën e administrimit serb Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës i janë shtuar 22.000 libra, të gjitha në gjuhën serbe dhe asnjë në gjuhën shqipe, ndërsa po në këtë periudhë 100.000 libra në gjuhën shqipe, të cilat kanë qenë të destinuara për shkëmbim dhe dhurim janë zhdukur nga administrata e dhunshme e këtij institucioni. Po kështu, në këtë institucion është bërë edhe një spastrim i madh i koleksioneve me vlerë nacionale, sidomos janë asgjësuar veprat e autorëve të traditës shqiptare.

Sipas të dhënave nga revizioni i koleksioneve bibliotekare në vitin 2004, koleksionet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës numërojnë 1.890.194 njësi bibliotekare, me 475.324 tituj, nga të cilat: libër: 382.806 njësi; revista: 281.591 njësi; gazeta: 984.022 njësi dhe botime të tjera: 241.775 njësi. Nga viti 2004-2008 pasurimi i fondeve bibliotekare në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, përmes ekzemplarit të detyrueshëm, blerjes dhe dhuratave, është rritur edhe për mbi 30.000 tituj të rinj.

Libri më i vjetër në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovë është *Historia e jetës dhe bëmave të Skënderbeut, Princit të Epirotëve*, i autorit Marin Barleti, përshkruar në gjuhën latine, i cili është përkthyer gjermanisht nga Johan Piniciani, botuar në Augsburg në vitin 1533.

Nga viti 2005 Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës e ka në funksion sistemin e automatizuar bibliotekar *Aleph 500* dhe deri në fillim të vitit 2009 katalogimi elektronik u është bërë 54.921 njësive bibliografike, apo 79.319 njësive fizike.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës përmes Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike ka qasje në revistat më të njohura elektronike në botë.

Veprimtaria bibliotekare zhvillohet edhe në bibliotekat ndërkomunale në Kosovë, të cilat konsiderohen si biblioteka të nivelit të dytë. Këto biblioteka funksionojnë në qendrat më të mëdha të Kosovës: në Prishtinë, në Prizren, në Pejë, në Mitrovicë, në Gjakovë, në Gjilan, në Ferizaj, në Leposaviq, ndërsa bibliotekat komunale në qytete më të vogla të Kosovës konsiderohen si biblioteka publike të nivelit të tretë.

Në vitet 1998-1999 në bibliotekat publike dhe private në Kosovë janë zhdukur dhe djegur me mijëra koleksione bibliotekare. Sipas burimeve vendore dhe ndërkombëtare, vetëm në 183 biblioteka në Kosovë ndërmjet viteve 1990-1999 kanë humbur afër 1.000 000 ekzemplarë të botimeve të ndryshme.

Në vitin 1989 në Kosovë kishte 328 biblioteka shkollore, ndërsa në vitin 1992 mbetën vetëm 146 biblioteka të tilla. Në vitin 1989 kishte 176 biblioteka publike, ndërsa në vitin 1995 mbetën vetëm 59. Para vitit 1990 në bibliotekat publike në Kosovë kishte 2.014.628 ekzemplarë, ndërsa pas vitit 1999 mbetën vetëm 1.114.060 ekzemplarë librash. Të dhënat statistikore dëshmojnë për një zhdukje masive të koleksioneve bibliotekare në gjuhën shqipe në shumicën e bibliotekave të Kosovës.

Në vitin 2005 në Kosovë kishte 498 biblioteka të të gjitha llojeve. Fondi i përgjithshëm i këtyre bibliotekave përbëhej nga 1.396 121 tituj dhe 3.465 372 njësi bibliotekare.

Veprimtaria bibliotekare në Kosovë zhvillohet edhe në institucione të tjera shkencore, arsimore, siç janë: Biblioteka e Akademisë së Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Biblioteka e Institutit Albanologjik, bibliotekat e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, pastaj bibliotekat shkollore etj.

Libri dhe bibliotekat në Kosovë kanë kaluar nëpër periudha të ndryshme të zhvillimit dhe të ndërprerjes. Faktet dhe dëshmitë tregojnë për fazat e zhvillimit dhe të afirmimit normal të veprimtarisë botuese dhe bibliotekare, por edhe për fazat e diskriminimit dhe të okupimit, duke filluar sidomos nga vitet e 80-ta të shekullit XX e deri në vitin 1999.

Zhvillimet e reja në sistemin bibliotekar në Kosovë kanë të bëjnë kryesisht me modernizimin e shërbimeve përmes teknologjisë së re të komunikimit dhe të qasjes së lirë në burimet e informacionit.

55 VJET TË LIBRIT SHQIP NË KOSOVË

Berat ARMAGEDONI

Bibliografët, ashtu sikurse biografitë, të cilat çdo ditë e më pak janë duke u pakësuar, edhe ata çdo ditë e më shumë janë duke u pakuar. Ky mosinteresim për të mos hartuar bibliografi është duke ardhur për shkak të zhvillimeve të shpejta teknologjike dhe ofrimit të shpejtë të informacionit nëpërmjet kërkimit elektronik, në të cilat, përpos të dhënave bibliografike, në të shumtën e rasteve mund të merren edhe të dhëna më të detajuara për disa kategori të fushave të studimeve e kategori të ndryshme të shkrimeve/teksteve sesa që ofrojnë bibliografitë klasike. Një mundësi të tillë, të marrjes së këtyre informacioneve, na ofron edhe programi elektronik "Aleph500", të cilin e përdor Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës për të kataloguar ose ofruar të dhëna elektronike për libra e autorë kudo që gjendet kërkuesi/shfletuesi.

Shikuar në këtë kontekst fushën e bibliografisë e këtë program elektronik mjaft të avancuar, në këtë numër të revistës "Biblioletra", jo që do të bëjmë ndonjë krahasim e nxjerrim në shesh përparësitë e njërit ndaj tjetrit, por do themi disa fjalë për bibliografinë, pasi, me një hartim të hatashëm të "Bibliografia: Libri shqip 1944-1999", të cilën janë duke e përgatitur e janë në përfundim të tij punonjësit e Departamentit të Bibliografisë, edhe është duke përfunduar metoda e vjetër e punës së saj, ajo e skedarëve manualë alfabetikë e duke dalë në dritë një punë e vjetër, por mjaft e vyeshme dhe e ndritshme: librat shqip që 55 vjet, e cila punë nuk do të ofrohet vetëm në formën



klasike, libër fizik, por kemi menduar ta bëjmë edhe moderne. Atë do të fusim edhe në portalin albanologjik Shqipëri - Kosovë, gjithashtu edhe në ueb-faqen e bibliotekës, që d.m.th. do t'ua ofrojmë edhe lexuesve virtualë.

"Bibliografia: Libri shqip 1944-1999" është projekt i Departamentit të Bibliografisë të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, i cili ka filluar të hartohet pak më shumë se dy dekada, kurse botimi tij pritet të dalë së shpejti në treg. Pra, kjo bibliografi ka filluar të hartohet nga punonjësit e saj, disa prej të cilëve tashmë kanë ndërruar jetë, disa të tjerë kanë dalë në pension, kurse disa të tjerë, të vjetër e të rinj, janë duke vazhduar ende të punojnë në këtë projekt.

Ky projekt i BKUK-së, për hartimin e kësaj bibliografie retrospektive kombëtare 55-vjeçare të librit shqip, përpos që ka futur të dhënat bibliografike të botimeve të librit shqip në Kosovë dhe në pjesët e dikurshme përbërëse të Federatës së ish-Jugosllavisë e ka pasur mundësi të marrë për model të punës biografi të ndryshme, duke filluar nga ajo e vitit 1946, kur supozohet se është hartuar bibliografia e parë, por e formës artikull, duke vijuar pastaj edhe me bibliografinë kronologjike të bibliografit Ali Rexha, me titull "Bibliografi publikimesh në gjuhën shqipe në Kosovë e Metohi 1944-1958", botuar në trembëdhjetë vazhdime në revistën shkencore "Përparimi" gjatë viteve 1959-1961 e deri në bibliografitë e sotme, (një të tillë, mjaft të rëndësishme, vitin e kaluar e ka botuar edhe Biblioteka e Shqipërisë), është punuar me përkushtim të madh. Ndërsa, të kujtojmë se, interesimi për të hartuar bibliografi tematike e kronologjike, speciale e përzgjedhëse (selektive), por për t'u botuar në formë të librit, ka nisur pas vitit 1957 e nuk është ndalur deri më sot, qoftë individualisht (bibliografi të hartuar nga një, dy e tre autorë), qoftë punë në grupe, sikurse, ta zëmë, është ky projekt i BKUK-së për hartimin e "Librit shqip 1944-1999", e cila bibliografi është e ndarë në tri vëllime, 1944-1974, 1975-1984, 1985-1999, dhe në të cilët janë futur - në të parën - 4 070 njësi bibliografike, në të dytën - 3 943, në të tretën mbi - 2 000 njësi, të dhënat e të cilave, në mbi 2 100 faqe tekst, i kanë futur në Microsoft Word ish-shefi i Departamentit të Bibliografisë, Tahir Foniqi, shefja e tashme e këtij Departamenti, Rrushe Behluli-Sadiku, dhe punonjësit: Albanë Mehmetaj, Flamur Maloku, Adil Olluri, Sanije Kelmendi dhe autori i këtij shkrimi. E, dizajnimin e saj e ka bërë disenjatori Liridon Zekaj, i cili është zyrtar i Teknologjisë Informative në BKUK.

Gjatë hartimit të kësaj bibliografie, sikurse thoshte redaktori përgjegjës i saj shpeshherë në mbledhje, Tahir Foniqi, ka pasur sfida të shumta dhe të ndryshme, mirëpo ato, falë tij, falë shefes Rrushe Behluli-Sadiku, por edhe interesimit të punonjësve ose pjesëmarrësve - hartues të saj - janë tejkaluar edhe shpejt, edhe shumë mirë, pa kërkuar ndihmë të jashtme e as futur në projekt ndonjë bibliograf jashtë institucionit të Bibliotekës, e cila na ka ofruar e dhënë mundësinë edhe për ndihmë të tillë. Por, ashtu sikurse e nisëm ne zbardhjen e saj (në Word), këta gjashtë-shtatë veta, ashtu edhe donim t'i jepnim fund, të vetëm.

Natyrisht se është bërë përpjekjeje, gjatë gjithë hartimit, të kihet kujdes në fushat përshkruese të librave të cilat i ofron bibliografia dhe të cilat i shton bibliografi me kllapa katrore [...], duke filluar nga ato më të shpeshtat: mbiemri (me shkronja kapitale) e emri i autorit, titulli i librit, kategoria (p.sh., novelë), bashkautorësia ose përpiluesit e hartuesit, ribotimet, vendi, botuesi, viti i botimit e shtypshkronja, faqet, ilustrimet, fotografitë, faqet shtesë e hartat, centimetrat, bibliotekat, parathëniet, pasthëniet, literatura, vërejtjet, fjalori e fjalorthi, tirazhi, shënimet për autorin e ndonjë shënim tjetër. Përpos këtyre fushave, për të cilat janë përkujdesur veçmas Foniqi e Behluli-Sadiku, rëndësi i është kushtuar edhe alfabetizimit të materialit bibliografik, i ndarë në vite, kur edhe fillon skeda e parë e vitit 1944, e cila ka këtë radhitje bibliografike:

GJILAS, Milovan

1. Thelbi dhe randsija e politikës s'onë të vllaznimit të popujve / Milovan Gjilas.- Prishtinë : Komiteti Krahinuer i PKJ për Kosmet, 1944 (Shapt. teknika e FPNÇ të Kosmetit).- 12 f. ; 20 cm

Tirazhi 500

Ndërkaq, te botimet e formës antologji, simpoziume, kongrese e botime të tjera të ngjashme është shënuar edhe përmbajtja e lëndës, e cila ka qenë mjaft e vështirë për t'u daktilografuar për shkak se skedat kanë qenë të punuara nga shumë duar të punonjësve të BKUK-së, shkrimi i të cilëve ka qenë i vështirë ku e ku të lexohet. Por, edhe kur janë hasur probleme të tilla, edhe kur shkrimi ka qenë i lexueshëm, nuk është lëshuar kurrë nga dora burimi kryesor: libri.

Së këndejmi, bibliografia është hartuar me organizim kronologjik, duke respektuar të gjitha zonat e përshkrimit bibliografik të librit. Brenda viteve është bërë alfabetizimi, germë për germë, i njësive bibliografike. Ndërsa, sikurse bën me dije redaktori përgjegjës i saj në hyrje të bibliografisë së vëllimit të parë, Tahir Foniqi: "Për hartimin e kësaj Bibliografie jemi mbështetur kryesisht në kopjen e detyruar të librit që merrte Biblioteka Kombëtare e Kosovës nga ish-RSFJ. Janë konsultuar edhe koleksionet shqipe në Bibliotekën Popullore të Serbisë, Bibliotekën Popullore dhe Universitare 'Kliment Ohridski' në Shkup, Bibliotekën e Institutit Albanologjik të Prishtinës, Bibliotekën e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, Bibliotekën Ndërkomunale "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë, Bibliotekën Ndërkomunale 'Anton Çetta' në Ferizaj, Bibliotekën Ndërkomunale në Prizren, Bibliotekën Ndërkomunale 'Azem Shkreli' në Pejë, Bibliotekën e ish-Shkollës Normale në Prishtinë, bibliotekat legatë: të Krist Malokit e Fehmi Aganit në BKUK, koleksionet e bibliotekës personale të poetit Azem Shkreli etj.". Ndërkaq, "në vjeljen e lëndës së kësaj Bibliografie, gjatë periudhave të caktuara, kanë ndihmuar edhe Sevdie Ahmeti, Musa Gërguri, Bujar Shehu, Afijete Mulliqi, Shkëlzen Maliqi, Nexhbedie Rizaj, Muharrem Zejnullahu". (Përshkrim më të detajuar, për punën rreth hartimit të kësaj bibliografie do të mund të lexoni në parathënien e saj në vëllimin e parë).

Këtu, në këtë përfundim, dua të kujtoj se bibliografisë i është nxjerr edhe indeksi i autorëve, kurse po në këtë bibliografi trevëllimesh janë lëshuar edhe gabime teknike, që do të thotë se, pavarësisht rëndësisë që i është kushtuar e kohës mjaft të gjatë derisa është hartuar, nuk është bërë një punë e shkëlqyeshme. Megjithatë, më mirë e këtij lloji sesa i gjithë ky informacion bibliografik të lihej i shpërndarë nëpër skedarët alfabetikë në BKUK. Tash librin shqip, që nga 1944 deri në të '99-n, mund ta keni në duar, në dashi edhe në kompjuter!

KUR LIGJI OBLIGON, PATJETËR DUHET ZBATIM

Flamur MALOKU

Muajin e kaluar u miratuan, kurse po muajin e kaluar për njërin filloi debati në Teatër Kombëtar, për tjetrin ka filluar që sa kohë edhe në dy ministritë, në atë të Kulturës dhe të Arsimit, në Rektorat dhe në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. E ato që u miratuan janë: Projektligji për Teatrot dhe ai për Bibliotekat. Pasi i përkas njërës fushë, kësaj të fundit, pasi punoj në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në Departamentin e Katalogimit e katalogoj ekzemplarin e detyrueshëm të të gjithë librave që botohen në Kosovë, qoftë ata me ISBN, qoftë të tjerët pa të, e pasi kam pritur deri tash miratimin e këtij projektligji, desha, për disa drejtues të shtëpive botuese, por edhe për opinionin, për lexuesit e "Biblioletrës" e për punonjësit e bibliotekave, t'i shkëpus në këtë shkrim disa nene të Projektligjit për Bibliotekat, gjithashtu edhe të njoftoj për një neglizhencë të disa shtëpive botuese, dhe të disa të tjerave që as sot nuk i respektojnë as ligjin, as bibliotekat, as lexuesit, duke mos i sjell pesë ekzemplarët e një botimi në bibliotekë, për të cilët i detyron ligji.

Projektligji për Bibliotekat në Republikën e Kosovës, në nenin 11, II Dispozitat e tjera, Botimet, obligon: "1. Çdo person ose subjekt që nxjerr botime në Kosovë, të cilat i dedikohen përdorimit publik, obligohet që pesë (5) ekzemplarë të çdo botimi t'ia dërgojë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës në afat prej 30 ditësh nga dita e botimit. Nëse botuesi nuk është i identifikuar ose është i identifikuar rrejshëm, i panjohur, përkatësisht nuk ka vendqëndrim ose seli në Kosovë, këtë obligim do ta kryej shtypshkronja, përkatësisht subjekti që ka bërë botimin. 2. Botime konsiderohen librat e shtypura dhe elektronike, materiali jo libër që nënkupton fonodokumentet, fotodokumentet, materiali i imët bibliotekar, broshurat, separatet, revistat, gazetat, riprodhimet artistike, veprat muzikore të shkruara në partitura, hartat gjeografike, atlaset, globuset e të gjitha llojeve, planet urbanistike, pllakatat, katalogët, programet, materialet braile, diapozitivat si dhe pjesët e tyre përbërëse a shoqëruese të riprodhuara në mënyrë grafike, CD-Rom-ët, DVD-të, disqet e gramafonit dhe kompakt-disqet, kasetat audio dhe vizuale të regjistruara, disketat kompjuterike të regjistruara dhe veprat e tjera që riprodhohen me shtypshkrim ose në një mënyrë tjetër të ngjashme.

Ndërkaq, në nenin 19, Materialet bibliotekare me rëndësi të veçantë, thuhet: "1. Çdo person në Kosovë që posedon material bibliotekar me rëndësi të veçantë për kulturën duhet:

"1.1. Të informojë Bibliotekën Kombëtare të Kosovës për evidentimin e materialit;

1.2. T'i mundësojë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës qasje në ato materiale dhe sipas nevojës të ndërmarrë masa për konservimin dhe restaurimin e tyre sipas marrëveshjes me poseduesin;

1.3. T'i ofrojë paraprakisht Bibliotekës Kombëtare të Kosovës blerjen e materialit të tillë, nëse ka për synim tjetërsimin e tij brenda apo jashtë vendit.

2. Nxjerrja e këtyre materialeve jashtë vendit për kohë të pacaktuar bëhet sipas legjislacionit në fuqi".

E nëse këto nene nuk zbatohen, atëherë ky ligj ka paraparë edhe masa

ndëshkimore sikurse janë përshkruar në nenin 20, te Dispozitat ndëshkimore:

"1. Me gjobë prej 100 - 1000 dënohet për kundërvajtje përdoruesi që nuk e kthen, e dëmton, tjetërson ose e asgjëson materialin bibliotekar ose në ndonjë mënyrë tjetër shkel rregullat e përdorimit të materialit bibliotekar.

2. Me gjobë prej 200 - 500 dënohet për kundërvajtje drejtuesi i bibliotekës nëse nuk ia dërgon Bibliotekës Kombëtare të Kosovës të dhënat e duhura.

3. Me gjobë prej 500 - 1000 dënohet për kundërvajtje botuesi, përkatësisht subjekti që nuk kryen obligimin e dërgimit të ekzemplarit të detyrueshëm në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

4. Me gjobë prej 200 - 1200 dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës i bibliotekës së sektorit publik i cili nuk ia dërgon Bibliotekës Kombëtare të Kosovës listën e koleksioneve të bibliotekës të cilat janë nxjerrë nga përdorimi apo listën e koleksioneve të bibliotekës që ka pushuar së funksionuari.

5. Me gjobë prej 500-5000 dënohen për kundërvajtje personat që posedojnë materiale bibliotekare me rëndësi për trashëgiminë kulturore të cilët nuk e njoftojnë Bibliotekën Kombëtare të Kosovës për tjetërsimin e tyre".

Edhe pse kaherë ka ekzistuar një rregull i shkruar ligjor, jo i fjalëpërfjalshëm sikurse tash i Republikës së Qeverisë së Kosovës, se "çdo person ose subjekt që nxjerr botime në Kosovë, të cilat i dedikohen përdorimit publik, obligohet që pesë (5) ekzemplarë të çdo botimi t'ia dërgojë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës në afat prej 30 ditësh nga dita e botimit", ai rregull, shikuar në 12 vjetët e fundit, është respektuar nga disa botues fare pak, nga disa plotësisht.

Pas një hulumtimi që kam bërë në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, pra në institucionin në të cilin punoj, kam vënë re se disa nga shtëpitë botuese nuk e kanë sjellë asnjë ekzemplar në BKUK; disa prej tyre nuk kanë marrë numër të ISBN-së dhe as që kanë kryer katalogimin në botim (CIP). Kjo papërgjegjësi bie ndesh me Ligjin për Bibliotekat. Sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Bibliotekat, botuesit e tillë, ndëshkohen, me gjobë prej 500 - 1000 , pasi nuk janë duke e kryer obligimin e dërgimit të ekzemplarit të detyrueshëm në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

Të kujtojmë, në këtë kontekst, se deri në dy vjetët e fundit as Instituti Albanologjik i Prishtinës, i cili boton libra, nuk e ka sjellë me kohë në BKUK ekzemplarin e detyrueshëm. E, respektim të ligjit e të lexuesit, e të kujdesshme për dorëzimin e ekzemplarit të detyrueshëm janë treguar shtëpitë botuese: "Faik Konica", "Rozafa", "Libri shkollor", Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Universiteti i Prishtinës, Shtëpia Botuese "Koha" e ndonjë tjetër, që kanë numër të kufizuar të botimeve.

Kur Ligji për Bibliotekat përcakton dispozita ligjore të obligueshme, ato duhet zbatuar, sepse moszbatimi i tyre cenon konceptet bazë mbi të cilat mbështet grumbullimi dhe ruajtja e materialeve kulturore, historike e shkencore të një kombi, duke privuar, në këtë kontekst, edhe të drejtën e përdoruesit për qasje në botimet të cilat një bibliotekë nacionale do të duhej t'i kishte.

ZHVILLIMI I KOLEKSIONEVE PËR BIBLIOTEKËN DIGJITALE KOMBËTARE TË KOSOVËS: PRITSHMËRITË E PËRDORUESVE*

/VIJON NGA BALLINA/

Mbase ka ardhur koha të rimendohet dhe të rivlerësohet pozicioni i bibliotekave të çfarëdolloji apo shërbimi që ofrojnë në raport me internetin dhe shërbimet elektronike komerciale që ofrohen, duke mos i konsideruar si rival, pasi edhe ashtu nuk kanë qenë asnjëherë, duke mos i konsideruar si shërbime më të mira të njërës sesa të tjetrës, kur dihet se secila në vetvete ofron shërbime unike dhe plotësuese në të njëjtën kohë, duke mos i konsideruar zëvendësues pasi njëra prodhon, grumbullon, shet e shërben, tjetra më shumë grumbullon, organizon e ofron.

Po të reflektojmë me naivitet për bibliotekat disa dhjetëra e qindra vjet më parë, natyrisht se do të themi sesa rehat dhe jashtë rrezikut të konkurrencës kanë qenë ato institucione (qoftë pronë individuale apo publike) meqë kanë pasur primatin e ofrimit të informacionit. A kemi të drejtë të bëjmë një gjykim të këtillë? Mendoj që jo, sepse edhe në atë kohë ka pasur kasnec lajmesh në mos agjenci lajmesh, sepse edhe në atë kohë ka pasur botues e distribues në mos amazoogëll, e-botues, e e-distribues. Pra, mendoj se ajo që i mbajti bibliotekat në trend atëherë e gjithë ditën është afërsia e tyre me sjelljen e njeriut, me mënyrën sesi ai dëshironte ta kishte informacionin, me mënyrën se çka i ofronte njeriut si mjedis e si shërbim, me qasjen elitiste e skolastike e pastaj më vonë edhe praktike, të hapur ndaj të gjithëve. Pra rreziku i bibliotekave, nëse e lejojmë ta quajmë këtë rrezik, vjen nga reagimi i tyre ndaj trendëve aktualë, pra ndaj ndryshimit të sjelljes së njerëzve, sesi dëshirojnë që t'u shërbehet informacioni, sesi e konsiderojnë bibliotekën, se ç'vlerë u japim shërbimeve dhe informacioneve të bibliotekës, etj. Pra, mund të themi se është rrezikim raporti mes bibliotekave dhe përdoruesve të saj, e mbase aspak një rrezikim raportesh mes bibliotekës dhe shërbimeve të tjerat të llojit të vet tashmë të transformuara dhe të përshtatura me sjelljet e ndryshuara të njerëzve.

Bibliotekat tona janë në rrugë drejt këtyre transformimeve me përpjekjet e bëra në këtë dhjetëvjetëshin e fundit, duke u përpjekur t'i shndërrojnë shërbimet e tyre tradicionale në elektronike, duke u përpjekur t'i ofrojnë materialet e tyre fizike në mënyrë elektronike, duke u përpjekur të jenë të pranishme gjithandej ku janë e ku s'janë përdoruesit e tyre. Megjithatë, duket se këto përpjekje nuk janë gjithëpërfshirëse, pra lënë një varg bibliotekash të tjera të papërfshira, ose janë gjysmake pasi nuk mund të plotënohen për shkak të mungesës së investimeve të nevojshme dhe të domosdoshme. Sidoqoftë, bibliotekat mund të reagojnë, së paku, me atë pjesë që u takon, pra të zhvillimit të planeve e strategjive për një transformim të tillë, të caktimit e përvetësimit të standardeve të zhvillimit, të projektimit e të kërkimit të fondeve. Pra, të hedhim hapin e parë që të bëjmë natyrshëm hapin e dytë e kështu me radhë. Pra, të mos hedhim hapin e parë të dytin, që do të na detyronte rishikim dhe korrigjim. Në këtë drejtim, jemi përpjekur që të hedhim themelet, mbase jo të plota, të koleksioneve të një biblioteke digjitale kombëtare përmes një hulumtimi të bërë kohë më parë.

Hulumtimi kishte për qëllim të përcaktonte, apo më mirë të themi, të niste diskutimet lidhur me kriteret e përzgjedhjes së koleksioneve që do të bëheshin pjesë e një biblioteke digjitale kombëtare sipas preferencave të shfrytëzuesve të saj. Me gjithë kufizimet që kishte, hulumtimi kishte për synim arritjen e dy objektivave:

- Hulumtimi i pritshmërive të ekspertëve dhe të përdoruesve lidhur me përmbajtjen e një biblioteke digjitale kombëtare, dhe;
- Identifikimi i kanaleve të mundshme të bashkëpunimit të bibliotekës me institucionet e tjera brenda dhe jashtë Kosovës

Metoda e përdorur kuantitative-kualitative e natyrës eksploruese, e mbështetur në analiza të thella përmes bashkëbisedimeve me ekspertë, anketave me përdorues aktualë e potencialë, analizës së dokumenteve parësore e dytësore, mundësoi në arritjen e disa rezultateve të cilat mendojmë se i japin një kuptim të rëndësishëm qenies së një biblioteke digjitale kombëtare. Hulumtimi u zhvillua brenda një periudhe kohore prej katër muajsh, ku u përfshin në biseda e anketa grupi i ekspertëve që përbëhej nga një ekspertë nga fusha e historisë, bibliotekarisë, letërsisë shqipe, etnomuzikologjisë, etnografisë dhe të arsimit; pastaj anketat u bënë me 188 persona, prej të cilëve 45.2% ishin përdorues aktual të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, gjersa 50% nuk ishin

* Ky punim është pjesë e shkëputur nga punimi i magjistraturës së bërë nga autori me pak ndryshime nga version origjinal për të paraqitur opinionet dhe reflektimet e tanishme mbi çështjet e diskutuara, meqë ka kaluar një periudhë që prej kryerjes së hulumtimit original. Versionin e plotë të hulumtimit original mund ta gjeni vetëm në gjuhën anglese në: http://dspace-unipr.cilea.it/bitstream/1889/1137/1/Kokollari_Besim_Master_Thesis_DILL.pdf

shfrytëzues, dhe afër 5% të tjerë nuk e identifikuan veten në ndonjërën prej këtyre dy kategorive. Shumica e të anketuarve vinin prej shkencave shoqërore - afër 67%, ndërsa rreth 25% nga shkencat ekzakte dhe 8% e tyre nuk u deklaruan.

Mbledhja e të dhënave u bë në dy faza. Në fazën e parë u bënë intervistat me ekspertë që është në vijë me natyrën e këtyre hulumtimeve. Fill pas tyre, u hartuan dhe u zhvilluan anketat që u bënë në formë elektronike dhe fizike. Të dhënat u analizuan po ashtu në dy faza: në fazën e parë u analizuan intervistat, duke i ndjekur të gjithë hapat e dëshmuar në hulumtimet kualitative, e pastaj edhe u bënë analizat e të dhënave kuantitative me softuer të përshtatshëm. Një hap tjetër analitik dhe sintetizues ishte edhe ndërthurja e këtyre dy lloj analizash për të plotësuar e përforcuar njëra-tjetrën. Gjersa, në njërën anë, bashkëbisedat me ekspertët ishin të strukturuara me rreth 17 pyetje, megjithatë biseda gjithmonë zgjerohej dhe shpeshherë rridhte lirshëm, duke trajtuar çështje e tema të ndryshme me interes për natyrën e hulumtimit, e në anën tjetër, anketat me përdorues aktual dhe potencial përbëhej gjithsej prej 8 pyetjeve me opsione të ndryshme. Së këndejmi, po i paraqesim në vijim rezultatet e hulumtimit në fjalë, të klasifikuara nën dy kategori kryesore: 1. Sugjerimet e ekspertëve, të dala nga bashkëbisedat me ta, dhe nën 2. "Pritshmëritë e përdoruesve aktualë dhe potencialë të bibliotekës" të dala kryesisht nga anketat me ta.

REZULTATET

1. Sugjerimet e ekspertëve

Në vijim janë paraqitur sugjerimet apo interpretimet e ekspertëve lidhur me zhvillimin e koleksioneve digjitale për një bibliotekë kombëtare pas analizimit të bashkëbisedave me ta, të cilat kryesisht përbëheshin prej shtatë pyetjeve të strukturuara. Sugjerimet e tyre janë grupuar, në formë të përmbledhur, në kuadër të temave të mëposhtme:

FUSHËVEPRIMI GJEOGRAFIK

Bashkëbisedat nxorën se fushëveprimi apo mbulueshmëria territoriale e bibliotekës digjitale kombëtare duhet të përqendrohet, në radhë të parë, në atë që sot e quajmë Kosovë. Pa dyshim se nuk mund t'i largoheshim domethënies së termit "Kosovë" dhe të territorit që e nënkuptonte kjo fjalë në kuadrin historik, e që natyrshëm e zgjeronte edhe më tej fushëveprimin territorial apo gjeografik. Për shembull, kjo nënkupton territorin e vilajetit të Kosovës nën pushtimin osman, apo tërësi të tjera territoriale nëpër periudha të ndryshme. Mbase, një riformulim më i saktë i fushëveprimit territorial do të ishte që koleksionet e një biblioteke të këtillë të përfshinin materialet e çmueshme të botuara për Kosovën brenda dhe jashtë vendit.

PËRMBAJTJE ME ORIENTIM HISTORIK

Procesi i bashkëbisedave nxori në pah se biblioteka digjitale kombëtare e Kosovës duhet të përfshijë në vetvete vepra që paraqesin periudhat më të hershme historike e deri më tani. Kjo nënkupton periudhat që nga antikiteti, ilirët në shekujt II deri XI e deri te deklarata e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 e më tutje. Përfshirja e veprave historike në formë digjitale do ta ndihmonte shtjellimin e rrëfimit për Kosovës nëpër periudha të ndryshme të zhvillimit historik.

PERIUDHAT HISTORIKE

Periudhat historike në vijim janë sugjeruar që të përfshihen në bibliotekën digjitale së bashku me disa veçori të tyre. Ato janë:

- Origjina e shqiptarëve që nga ilirët, si dhe vazhdimësia Ilire-Arbënore nga shekulli II-XI. Njëri prej të intervistuarve përmendi se kjo vazhdimësi do të mund të paraqitej mjaft mirë përmes veprave të Gustav Mayer, Norber Jokl, Eqrem Çabej, dhe të tjerëve. Ndërsa, një tjetër e theksoi lidhjen e territorit të Kosovës me atë të Dardanisë antike, e cila duhet të pasqyrohet patjetër në një bibliotekë digjitale të natyrës kombëtare.

- Periudha e hershme e mesjetës, duke përfshirë Betejën e Kosovës dhe të gjithë të vërtetën rreth saj.

- Periudha e Skënderbeut e shekullit XV, e cila është një ndër periudhat më të rëndësishme të historisë së shqiptarëve. Kjo periudhë "shënon periudhën e shtetësisë Arbënore meqë emri 'shqiptar' rrjedh mu prej kësaj periudhe", u shpreh një nga të intervistuarit. Andaj kjo periudhë edhe është e lidhur me figurën e Gjergj Kastriot Skënderbeut, e edhe me përpjekjet e shtetësisë së parë shqiptare në kuptimin modern të fjalës. Kjo periudhë mund të paraqitet mjaft mirë përmes veprave të Marin Barletit, Marin Bicikemit etj., që ka një varg versionesh për historinë e Skënderbeut, si dhe vepra të autorëve të huaj të cilët kanë shkruar gjerë e gjatë për këtë figurë madhështore dhe periudhën e tij.

- Pushtimi i Perandorisë Osmane i territoreve shqiptare nga shekulli XV deri XX paraqet një periudhë tjetër të rëndësishme të historisë. Një theks i veçantë duhet t'i kushtohet digjitalizimit të regjistrave kadastral të vilajeteve shqiptare, e në veçanti të vilajetit të Kosovës. "Këta regjistra janë krijuar t'u shërbejnë nevojave të Perandorisë Osmane, por ato edhe përmbajnë informacione lidhur me shpërndarjen e popullsisë që ekzistonte në atë kohë. Ato janë origjinale dhe mund të shërbejnë si materiale e dëshmi të dorës së parë të vazhdimësisë iliro-shqiptare", u shpreh njëri nga të intervistuarit.

- Periudha e Rilindjes (e njohur edhe si periudha e zgjimit kombëtar) është një periudhë tjetër që nis nga shekulli XIX deri në fillim shekullin e XX. Në të vërtetë kjo periudhë paraqet periudhën e dytë më të rëndësishme të historisë shqiptare pas epokës së Skënderbeut. U theksua se në këtë periudhë

janë të rëndësishme letërkëmbimet e veprimtarëve të Rilindjes. Ato korrespondenca janë dëshmi e prejardhjes Ilire-shqiptare, si dhe janë shkruar disa prej veprave më të rëndësishme të letërsisë shqiptare mu në atë periudhë. Kjo periudhë është njohur edhe për Lidhjen e Prizrenit, e cila i mblodhi të gjithë shqiptarët në mbrojtje të kombit dhe të pavarësisë.

- Periudha e Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, e cila u shoqërua më luftëra e trazira pasi Kosova u nda mes shteteve të Ballkanit. Ekzistojnë shumë dokumente dhe raporte të konsullatave të kohës. Dokumentet e atëhershme shërbejnë si dëshmi e masakrave më makabre ndaj shqiptarëve në kohën kur territori u pretendua nga bullgarët, serbët dhe malazezët. Janë shumë të rëndësishme për t'u digjitalizuar dhe për t'u paraqitur në bibliotekën digjitale raportet e shkruara nga Lazer Mjeda, peshkop i rajonit të Prizrenit dhe Shkupit, rreth gjendjes së asaj kohe. "Ai ishte shqiptari i vetëm që i raportonte Vjenës dhe Vatikanit lidhur me ngjarjet e kohës. Andaj, të gjitha shkrimet, artikujt në gazetat prestigjioze të kohës, si në Times, pastaj në ato gjermane e britanike, bazoheshin në këto raporte", na tha njëri prej të intervistuarve.

- Lufta e Parë dhe Lufta e Dytë Botërore janë të rëndësisë së vet. Në të parën, Kosova u pushtua nga mbretëria serbo-kroate-sllovene. Ndërsa në të dytën, ajo u aneksua nga Jugosllavia. Ekzistojnë dokumente me bollëk që dëshmojnë azil kërkimin e shqiptarëve në vende të tjera jashtë territoreve amë të tyre, dhe se ato gjinden në Arkivin e Kosovës.

- Periudha pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitet e 60-ta paraqet pakënaqësitë e shqiptarëve të Kosovës përmes lëvizjeve të shumta ilegale, siç quheshin nga regjimi i atëhershëm Jugosllav. Kjo periudhë mund të paraqitet shumë mirë përmes figurave të Shaban Polluzhës, Nuh Prelleshit, e shumë të tjerëve.

- Periudha e viteve 1960-1970 është periudhë e shprehjes së ndjenjave kombëtare të shqiptarëve. Demonstratat e vitit 1968 kishin ndikim pozitiv në mirëqenien e shqiptarëve të Kosovës nën Jugosllavinë e atëhershme. Ato demonstrata, në veçanti, sollën më shumë të drejta për shqiptarët në Kosovë, si dhe në themelimin e institucioneve të larta shkollore, d.m.th të Universitetit të Prishtinës. Themelimi i Universitetit paraqiste një prej arritjeve më të mëdha të kohës meqë më vonë prodhoi prijës të cilët e udhëhoqën Kosovë në realitetin e sotëm. Kështu që dy të intervistuar u shprehën se dokumentet që shërbejnë edhe si dëshmi të ngjarjeve që rrodhën në atë kohë, si dhe dokumente që tregojnë historinë e themelimit të Universitetit të Prishtinës, si vendime, procesverbale takimesh, janë të gjitha të rëndësishme që të përfshihen në bibliotekën digjitale.

- Periudha prej viteve 1980 deri në ditën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës përbën një periudhë në vete. Në këtë periudhë kanë ndodhur shumë ngjarje, duke përfshirë demonstratat e vitit 1981, ku u kërkua republika; pastaj rezistenca paqësore në vitet e 90-ta; deklarata e kushtetutës në vitin 1990, deklarata e Republikës së Kosovës në vitin 1992; themelimi i institucioneve paralele; lufta e vitit 1998/1999, duke përfshirë rezistencën ushtarake të UÇK-së dhe bombardimet e NATO-s; administrimin e Kosovës nga Kombet e Bashkuara; Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Ekzistojnë përplot dokumente të shkruara, elektronike, filma për të gjitha këto ngjarje të cilat janë me rëndësi të digjitalizohen dhe të paraqiten përmes bibliotekës digjitale kombëtare. Megjithatë, njëri prej historianëve e tërhoqi vëmendjen se një vëmendje e veçantë në mesin e këtyre ngjarjeve duhet t'i kushtohet periudhës së UÇK-së.

Historia e Kosovës është e lidhur me historinë e Shqipërisë dhe të territoreve të tjera shqiptare në gadishullin ballkanik. Megjithatë, tregimi i rrëfimit për Kosovën përmes dokumenteve të llojllojshme duhet të shkojë deri në rrënjët ilire përmes shekujsh e tek më vonë të përqendrohemi më shumë në territorin e Kosovës, kur kjo është më e mundur, sidomos pas vitit 1912, periudhës nën Jugosllavi e deri te Shpallja e Pavarësisë në vitin 2008, që gjithsesi paraqet një histori unike në zhvillim e sipër, një histori në vete e veçuar paksa nga territoret e tjera shqiptare, por natyrisht se me ndikim në to.

NGJARJE TË VEÇANTA HISTORIKE

Ngjarjet historike të cilat e krijuan identitetin kombëtar dhe shtetëror të Kosovës lidhen me vetë periudhat e historisë shqiptare. Megjithatë, të intervistuarit i dalluan disa ngjarje të cilat i shohin si më të rëndësishme dhe të nevojshme të përfshihen në bibliotekën digjitale kombëtare, pasi e paraqesin argumentin e Kosovës dhe të shqiptarëve dhe të identitetit të tyre si komb.

Këto ngjarje përfshijnë: luftërat e Skënderbeut; Lidhjen e Prizrenit; Konferencën e Londrës; Shpalljen e Pavarësisë së vitit 1912; Konferencën e Paqes së Versajës; Konferencën e Bujanit; Lutën e Dytë Botërore dhe aneksimin e Kosovës; lëvizjet ilegale pas Luftës së Dytë Botërore, posaçërisht ato me unifikimin e territoreve shqiptare; aktin e Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë për dërgimin e mësimdhënësve në Kosovë për ta mbështetur arsimin në këtë territor pas Luftës së Dytë; demonstratat e vitit 1968, themelimi i Universitetit të Prishtinës; themelimi i Akademisë së Shkencave të Kosovës; Kushtetuta e vitit 1974; demonstratat e vitit 1981; periudha e heqjes së autonomisë së Kosovës në vitin 1989; grevat e minatorëve në vitin 1989; ngjarjet e 90-tave kur të gjitha institucionet u okupuan nga regjimi serb; lëvizjet e para për pavarësinë e Kosovës, duke përfshirë themelimin e partive politike në Kosovë, si LDK-ja, si dhe kri-

jimi i institucioneve paralele të Kosovës; demonstratat e studentëve të vitit 1997; akti i daljes publike të UÇK-së dhe lufta e saj; bombardimet e NATO-s; eksodi i shqiptarëve të Kosovës në Bllacë dhe vendet e tjera në vitin 1999, të cilin njëri prej të intervistuarve e quajti vit biblik të lidhur me eksodin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë; Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008.

FIGURAT E SHQUARA HISTORIKE

Gjatë intervistave u spikatën tri figura kryesore dhe të shquara historike që duhet të dallohen në mesin e të tjerëve, si përfaqësuesit më të fuqishëm të identitetit tonë kombëtar, historik dhe humanitar. Ato janë Skënderbeu, Nënë Tereza dhe Adem Jashari.

DOKUMENTE HISTORIKE

Shumica e dokumenteve të përmendura lidhen me periudhat dhe ngjarjet e ndryshme historike të përmendura më lartë. Megjithatë, në kërkesën për të përmendur disa prej dokumenteve që të intervistuarit i shohin si më të veçanta në aspektin historik dhe kombëtar për t'i paraqitur në bibliotekën digjitale u identifikuan disa lloje:

- Dokumente në lidhje me vendet arkeologjike në Kosovë të cilat e dëshmojnë antikitetin e kombit tonë;
- Illyricum Sacrum, me theks të veçantë pjesa VIII pasi ka dëshmi tejet të rëndësishme për Kosovën e lashtë (Dardaninë);
- Dokumente në lidhje me regjistrat kadastrale të periudhës Osmane që kanë të bëjnë me vilajetin e Kosovës;
- Dokumente në lidhje me Lidhjen e Prizrenit, të cilat kanë rëndësi posaçërisht me identitetin kombëtar;
- Dokumente lidhur me Kongresin e Berlinit;
- Dokumente lidhur me Konferencën e Paqes së Versajës;
- Dokumente lidhur me Konferencën e Londrës;
- Dokumente lidhur me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë;
- Raportet e Lazer Mjedës gjatë viteve 1912, të cilat e pasqyronin gjendjen në atë kohë;
- Dokumente lidhur me Konferencën e Bujanës, gati në fund të Luftës së Dytë Botërore;
- Procesverbalet e Parlamentit të Shqipërisë gjatë viteve të 1920-ta, me theks të veçantë diskutimet lidhur me Kosovën;
- Kushtetuta e vitit 1974;
- Deklarata Kushtetuese e vitit 1990;
- Dokumente lidhur me Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës në vitin 1992;
- Kushtetuta e Kosovës në vitin 2008.

Gjithashtu u përmendën edhe shumë dokumente, revista, letërkëmbime të personave të shquar të cilat sjellin fakte lidhur me zhvillimet historike në trevat shqiptare, por edhe në Kosovë në veçanti.

PËRMBAJTJE ME ORIENTIM LETRAR

Letërsia zë një vend të veçantë në kulturën, historinë dhe zhvillimet e gjithmbarshme të një kombi. Të shpeshtën e herëve, historia dhe kultura e një kombi njihet vetëm në saje të veprave letrare. E kjo spikatet më së tepërmi në shkrimet e para në historinë e një kombi, të cilat paraqesin fakte e dëshmi të rëndësishme historike, letrare dhe kulturore. Edhe kombi ynë nuk përjashtohet nga këto zhvillime, dhe letërsia si e tillë duhet të ketë një vend të posaçëm në bibliotekën digjitale kombëtare. Procesi i intervistave nxori disa periudha e dokumente letrare me rëndësi të përfaqësohen në një mënyrë a tjetër në bibliotekën digjitale.

PERIUDHAT E LETËRSISË

Periudhat letrare me rëndësi të përfshirjes:

- Letërsia e vjetër shqiptare (1555-1762). Viti 1555 paraqet botimin e veprës së parë në shqim "Meshari", ndërsa viti 1762 paraqet fundin e kësaj periudhe me botimin e veprës "Gjella e Shën Mërisë Virgjër" në Romë.
- Letërsia e romantizmit shqiptar (1844-1900). Kjo periudhë shquhet me veprën e Naum Veqilhargjit "Evëtar", ndërsa viti 1900 paraqet përfundimin e kësaj periudhe me vdekjen e shkrimtarit të madh Naim Frashëri.
- Letërsia moderne shqiptare (1900-1945). fillon me Gjergj Fishtën dhe mbaron në vitin 1945 me instalimin e ideologjisë komuniste.

Siç mund të shihet edhe periudhat letrare janë të ndërthurura ngushtë me letërsinë shqiptare në përgjithësi, dhe se nuk mund të bëhet ndonjë ndarje e logjikshme e një letërsie vetëm 'kosovare', ashtu siç nuk ndodh as me një histori vetëm 'kosovare'. Andaj bashkëpunimi gjithëshqiptar, e sidomos i Prishtinës dhe Tiranës, është i domosdoshëm në integrimin e burimeve të ndryshme në ndonjë portal të bibliotekave digjitale të dy vendeve, siç është nisma e fundit me Portalin Albanologjik.

DOKUMENTE LETRARE

Disa dokumente letrare dhe gjuhësore u përmendën nga të intervistuarit si dokumente me rëndësi të veçantë për trashëgimin e shkruar:

- Formula e pagëzimit (1462)
- Fjalori i Arnold Von Harfit (1497).
- Ungjilli i Pashkëve (shekulli XV).
- Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut nga Marin Barleti.
- Meshari i Gjon Buzukut:
- Çeta e profetëve e Pjetër Bogdani.
- Kanuni i Lekë Dukagjinit nga Shtjefën Gjeqovi.

SHKRIMTARËT

Megjithëse intervistat nxorën në pah se pothuaj është më së miri që secila periudhë letrare të përfaqësohet me autorët më të shquar dhe veprat e tyre, prapë se prapë u përmenden disa shkrimtarë në suaza të përgjithshme me rëndësi që të përfshihen në bibliotekën digjitale. Ata janë: Marin

Barleti, Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Jul Varboba, Pjetër Zarishi, Nazim Berati, Hasan Zyko Kamberi, Muhamed Kyçyku, Naum Veqilhargji, Jeronim De Rada, Konstandin Kristoforidhi, Naim Frashëri, Zef Serembe, Zef Skiroi, Sami Frashëri, Gjergj Fishta, Faik Konica, Mithat Frashëri, Fan S. Noli, Ali Asllani, Lasgush Poradeci, Etëhem Haxhiademi, Ernest Koliqi, Mitrush Kuteli, Millosh Gjergj Nikolla (Migjeni), Atë Zef Pllumi, Esat Mekuli, Hivzi Sulejmani, Martin Camaj, Anton Pashku, Ismail Kadare, Bilal Xhaferri, Kasëm Trebeshina, etj.

TRASHËGIMIA KULTURORE

Trashëgimia kulturore si koncept mjaft i gjerë u kategorizua në dy klasë kryesore, në trashëgimi të prekshme (fizike), si vende historike, artefakte, etj., si dhe në vlera të paprekshme (jofizike), siç janë traditat, zakonet, këngët tradicionale, tradita gojore, etj.

TRASHËGIMIA E PREKSHME KULTURORE

Ky lloj i trashëgimisë me interes të përfaqësimit në bibliotekën digjitale për audiencën e brendshme dhe të jashtme përfshinë:

Vendet arkeologjike. Me theks të veçantë Ulpiana, Halilaqi, NovoBërda, Trepça, Radac. Ekzistojnë edhe një numër dokumentesh lidhur me këto vende të rëndësishme që meritojnë përfshirjen.

Monumentet. Duke përfshirë xhami, kisha, kulla. Pastaj, Kështjella e Prizrenit, e cila i përket periudhës pararomake dhe osmane. Në anën tjetër, kulla zë vend të veçantë po ashtu pasi paraqet zhvillimin gradual dhe të mirëfilltë të shtëpive shqiptare të banimit. Ato gjenden edhe sot e kësaj dite, kryesisht në rajonin e Deçanit, Isniq, por edhe në vende të tjera, sidomos në rajonin e Dukagjinit.

Instrumentet muzikore. Përfshirja e instrumente muzikore paraqet po ashtu një trashëgimi të pasur pasi Kosova shquhet për llojshmërinë e tyre në mbarë territorin, duke përfshirë nga instrumentet idiofone (zilet në djepin e fëmijëve); kordofonet, si çiftelia, sharkia e lahuta; membranofone, si tupani, dhe; aerofone, si fyelli, kavalli, popëza, burazana, bizhnica, etj.

Veshjet. Veshjet kombëtare paraqesin një pasuri tjetër zhvillimore e kulturore, e që janë karakteristikë e rajoneve të ndryshme të Kosovës. Andaj dallojmë disa sosh, si veshja e Rugovës, plisi, veshjet e grave të rajonit të Hasit, Opojës dhe Zhurit. Andaj të gjitha këto duhet të përfaqësohen në forma të ndryshme në bibliotekën digjitale, e mbase më së miri përmes fotografive dhe përshkrimeve dhe informacionit të funksionit të tyre në rajonin përkatës. Prania e tyre do të mundësonte shkëmbimin e kulturës tonë me kulturat e tjera duke arritur në një kuptim më të madh ndërkulturor.

TRASHËGIMIA E PAPREKSHME KULTURORE

Territori i Kosovës është i pasur me trashëgimi të tillë kulturore, ku mund të përfshihet, për shembull, muzika tradicionale, këngët e vallet tradicionale, zakonet kombëtare, ushqimi, tradita e dasmave, besëtytnitë, ritualet.

Këngët tradicionale. Në bibliotekën digjitale mbase mund të paraqiten së paku tri lloj të këngëve tradicionale, si ato të dhembjes a pikëllimit, të zisë dhe ato të dasmave. Këto lloj këngësh janë të veçanta dhe lidhen me rajone të ndryshme. Këngët e pikëllimit më së tepërmi këndohen nga burrat dhe janë shumë të rralla; ato të zisë këndohen nga gratë dhe gjinden kudo në Kosovë. Ndërsa këngët e dasmave zhvillohen në faza të ndryshme të procesit të martesës – pra ka këngë të posaçme që këndohen dy tri ditë para ditës së dasmës në shtëpinë e nuses, dhe një varg këngësh prej dy javësh para ditës së dasmës në shtëpinë e dhëndrit.

Pastaj, kemi një varg këngësh epike që shoqërohen me sharki e çifteli. Po ashtu janë karakteristike edhe këngët malësorçe dhe ato me gisht në fyt. Të gjitha kanë një vlerë të jashtëzakonshme për kulturën tonë nëse paraqiten në një format ose në një tjetër, si dhe të organizuara dhe të sistemuara në një mënyrë që të kenë kuptim në bibliotekën digjitale – natyrisht të shoqëruara me ndonjë shpjegim të përshtatshme për natyrën e tyre.

Vallet. Në traditën tonë kulturore ekzistojnë një varg vallesh të cilat janë bartur nga një brez në tjetrin, u shpreh etnomuzikologu gjatë intervistës. Është me rëndësi që të pasqyrohen në bibliotekën digjitale filma dokumentar lidhur me vallet e Opojës, pastaj ato të Rugovës që u ngjasojnë valleve të luftës të shoqëruara me shpata dhe armë të ftohta, më pas vallet e grave nga Rrafshi i Kosovës dhe ato të rajonit të Dukagjinit e të Karadakut.

Ritualet. Kosova është po ashtu e pasur me traditën e ritualeve. Ky lloj i trashëgimisë së paprekshme ka të bëj me ritualet si Shën Gjergji, Shmitëri, Buzmi, ritualet e korrje-shirjeve, ndjellja e shiut, gjatë gatimit të bukës në çerep, etj. Ritualet zakonisht shoqërohen me këngë. "Ritualet nuk janë shumë aktive sot siç mund të mendohet, porse ishin aktive në kohërat e mëhershme", theksoi etnomuzikologu i intervistuar. Andaj, biblioteka digjitale do të luaj një rol të rëndësishëm jo vetëm në paraqitjen e këtyre vlerave, por edhe në ruajtjen e saj, e cila po mos të ruhet në një formë a në një tjetër nga institucionet bibliotekare, muzetë, arkivat, etj., mund të zhduket pa lënë gjurmë të mëdha u shpreh etnomuzikologu i intervistuar.

GJURMËT E JETESËS QË NGA KOHËRAT E LASHTA

Në Kosovë ende mund të shihen gjurmët e mënyrës së jetesës që është zhvilluar që në kohët e lashta. Etnografi i intervistuar na solli dy shembuj sesi njerëzit e organizojnë jetën dhe besimet e tyre.

Njëra mënyrë e organizimit të jetës është përmes kalendarit. Sipas etnografit, shqiptarët e kanë ruajtur në ku-

jtesën e tyre atë qe e quan "kalendari i punës", i cili është po aq i lashtë sa Babilonia dhe Egjipti. Kalendari, sipas tij, përfshinte 365 ditë, të ndarë në dy stinë (Pranverë dhe Dimër), secili prej tyre nga 8 muaj me nga 45 ditës plus 2-3 ditë në "krye të vitit". Ky kalendar e ka terminologjinë e vet, si "Lagshsi," "brymsi" (për vjeshtën), "djegaguri" (për gushtin), etj.

Një element tjetër i këtyre gjurmëve të lashta në aspektin e asaj që besojnë është mënyra e të bërit të beve dhe të mallkimeve te shqiptarët. Sipas etnografit, malësorët, edhe sot e kësaj dite, kur bëjnë be do të thonë "Për tokë e për qiell" ose "Pasha diell e pasha hanë". Kur mallkojnë, për shembull, ata thonë "T'u rrezoftë hana", ose "T'u fiktë dielli". Pra, këtu është me rëndësi të theksohet se fjala "zot" nuk përmendet, i cili paraqet një element të monoteizmit. Sipas etnografit, këto elemente të para-paganizmit kur njeriu besonte në elementet e natyrës ruhen edhe sot në Kosovë.

Këto janë disa elemente etnografike të cilat mund ta identifikojnë Kosovën si një territor unik mes kombeve e shteteve të tjera. Këto vlera duhet të mblidhen dhe të paraqiten në ndonjë formë përmes bibliotekës digjitale. E kjo mbledhje mund të bëhet, sipas etnografit, në formë të organizimit të grupeve të ekspertëve në bashkëpunim me institutin Albanologjik, për shembull, dhe të dilet në ekspeditë në terren pasi gjurmët e këtyre elementeve janë ende të gjalla. Sipas tij mënyra më e mirë për t'i kapur këto elemente dhe të tjerat që u diskutuan më lartë është përmes incizimeve me video, e cila mund të kapë mimikat, emocionet, ndjenjat, ngjyrat, etj. "Po ta intervistojmë, për shembull, një pak se si janë argëtuar gjatë mbrëmjeve në kohën e tyre, dhe nëse ai i ka përjetuar ato net argëtuese vetë, atëherë në ato momente ai do ta ngrit tonin e zërit, etj. Video kamera është mbase mjeti i vetëm që do t'i kapte këto nuance", u shpreh etnografi gjatë intervistës.

Siç shihet, biblioteka(t) mund të luajnë një rol të rëndësishëm në kapjen e këtyre elementeve kulturor-etnike dhe t'i paraqesin para botës. Megjithatë, këto aktivitetet, sidomos në mbledhjen e tyre, duhet të organizohen shumë mirë dhe me shumë kujdes me institucionet e tjera në Kosovë përmes ndonjë projekti bashkëpunues, në mënyrë që historia gojore, mënyrat e jetesës, traditat e lashta të cilat mund t'ia gjejmë edhe sot gjurmët të ruhen në formë digjitale përmes rrëfimeve, video-incizimeve dhe mënyrave të tjera të përshtatshme. Është me rëndësi të ceket se biblioteka nuk mund të veprojë e vetme në këtë përpjekje pasi nuk mund të arrihen rezultate të dëshirueshme pa ekspertizën dhe përvojën nga jashtë.

JETA RELIGJIOZE

Jeta religjioze në Kosovë konsiderohet në përgjithësi më tolerantja. Fe të ndryshme kanë jetuar dhe jetojnë pranë njëra-tjetrës pa ndonjë problem, përfshirë myslimanët, katolikët dhe ortodoksët. Prandaj kjo tolerancë duhet të paraqitet përmes bibliotekës digjitale. Në mesin e figurave religjioze të përmendura nga të intervistuarit dhe që meritojnë të zënë vend në një bibliotekë të tillë ishin: Flori dhe Lauri, shenjtët e parë shqiptar; Nënë Tereza, e njohur botërisht për humanitetin e saj; Fan Noli, si fetar ashtu edhe kombëtar; Gjon Buzuku, autor i "Mesharit; Don Nikollë Kazazi, i cili e zbuloi veprën e parë shqiptare të shkruar, pra "Mesharin"; Lazër Mjedën; Gjergj Fishtën, figurë fetare dhe shkrimtar i shquar; Hoxh Tahsinin dhe Ymer Prizrenin që të dy figura fetare dhe kombëtare, etj.

GJUHA E MATERIALIT

Intervistat nxorën në dritë dy pikëpamje të paraqitjes së materialeve në bibliotekën digjitale në aspektin gjuhësor – në ata që materiali të paraqitej në gjuhën angleze në mënyrë që bota të njoh më mirë kulturën tonë të pasur, dhe në ata që kërkonin që materiali të jetë si në shqip ashtu edhe në anglisht. Po ashtu, sipas të intervistuarve një mori materialesh janë të krijuara në latinisht e greqishte të vjetër, dokumente që dëshmojnë edhe vetë emrin shqiptar "Albanoi" që datojnë që nga shekulli II e që janë në greqishte. Edhe gjuhët e tjera janë të pranishme në dokumentimin e shqiptarëve, si bullgarishtja e vjetër, serbishtja e vjetër, osmanishtja e vjetër, arabishtja dhe turqishtja. Këto janë gjuhë me të cilët dijetarët shqiptarë shpreheshin në periudha të ndryshme. Andaj është me rëndësi të ruhet origjinaliteti i tyre, natyrisht të shoqëruara me ndonjë transkribim në gjuhët moderne në mënyrë që të interesuarit të dinë se për çka bëhet fjalë.

Pra, edhe nga aspekti gjuhësor dhe aspekte të përmendura më lart si të mbledhjes së materialeve, kompleksiteti i bibliotekës digjitale është tejet i madh dhe kërkon bashkëpunim të gjerë dhe ekspertizë të kombinuar të institucioneve e individëve të ndryshëm. Biblioteka digjitale e karakterit kombëtar duhet të mbledh materiale të gjuhëve të ndryshme pasi ky territor ishte në komunikim me rajone, gjuhë, kultura e tradita të ndryshme ose përmes luftërave, pushtimeve, apo në paqe me shumë qytetërime, përfshirë perandorinë romake, osmane, mbretërinë serbo-kroate-sllovene, etj. Gjuhët, si frëngjishtja, anglishtja, gjermanishtja, spanjisht dhe gjuhët e sotme moderne nuk duhet të lihen anash, e sidomos në lidhje me historinë e kohëve të fundit. Meqë ka një varg gjuhësh të cilat lidhen e ndërlidhen me shkrime që kanë të bëjnë me kulturën, historinë, traditat, zhvillimet shoqërore, shkëmbimet tregtare, luftërat, etj., atëherë mbetet detyrë e institucioneve bibliotekare të para-

qesin prioritetet gjuhësore mbi bazën e së cilave do ta mblidhen materialet, sidomos të atyre të krijuara në gjuhët e tjera. Natyrisht se duhet pasur parasysh se natyra dhe rëndësia e ndonjë materiali shkon përtej kufijve gjuhësor, territorial, e aspekteve të tjera që mund ta rregullojnë një çështje të caktuar.

FORMATI DHE LLOJI I MATERIALIT

Formatet e përmendura që të përdoren në bibliotekën digjitale përfshijnë: fotografi, audio, video, dokumente të skanuara, etj. Po ashtu, edhe formate e lloje të ndryshme të dokumenteve duhet të përfshihen, si: doreshkrime, dokumente origjinale, dokumente zyrtare, letërkëmbime, pjesë të përzgjedhura të periodikut të vjetër; dokumente të botuara, si: libra, gazeta dhe lloje të tjera të botimeve me rëndësi kombëtare. Formatet duhet të përcaktohen edhe në përputhje me zhvillimet teknologjike si dhe me mënyrën e ndryshimit të sjelljes së përdoruesve.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA

Ekspertët e intervistuar sugjeruan bashkëpunim të dyanshëm: bashkëpunimin i bibliotekës me institucione brenda Kosovës, dhe bashkëpunimi me institucione jashtë Kosovës.

Bashkëpunimi i bibliotekës me institucionet e brendshme përfshin: institucionet zyrtare dhe publike, që mund të jenë biblioteka, media, si televizionet publike, institute Albanologjik, Institutin e Historisë, Akademinë e Shkencave, Qeverinë e Kosovës, Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve, etj; pastaj arkivat, muzetë, si Arkivi i Kosovës, Muzeu Kombëtar; institucionet fetare, duke përfshirë kishat, xhamitë, institucionet e tjera myslimane e katolike, etj.

Po ashtu procesi i intervistave nxori në pah se nuk duhet të mungojë edhe bashkëpunimi me individë e institucione private, të cilët kanë dhe ruajnë dokumente të rëndësishme. Janë përmendur individë nga qytetet, si: Prizreni, Gjakova dhe Peja, të cilët janë në posedim të doreshkrimeve dhe dokumenteve me vlera të mëdha. Individët dhe një mori dokumentesh të tilla janë identifikuar përmes një granti të dhënë nga Ambasada e SHBA-ve në Kosovë për Bashkësinë Islame në vitin 2001 dhe 2003, i cili kishte për qëllim inventarizimin e këtij thesari në mënyrë që mos të kontrabandohet ose të mos shitet jashtë vendit, meqë një gjë e tillë edhe rregullohet me ligjet përkatëse të Kosovës.

Ekspertët e intervistuar sugjeruan edhe një varg institucionesh të huaja me të cilat biblioteka duhet të bashkëpunoj në lidhje me vjeljen e dokumenteve të rëndësishme për historinë, identitetin dhe kulturën tonë. Ato përfshijnë:

- Arkivin e Vatikanit, posaçërisht lidhur me dokumentet e periudhës së mesjetës. Edhe arkivat e tjera italiane, si ai i Romës, paraqesin rëndësi të rëndësishme për kulturën dhe historinë shqiptare.

- Arkivin e Raguzës (Dubrovniku i sotëm në Kroaci), i cili përmban dokumente me vlerë për lidhjet e qyteteve të Kosovës, dhe atyre shqiptare, me Raguzën duke shkuar gjer në kohën e Skënderbeut.

- Arkivat e Rumanisë dhe Bullgarisë, Zvicrës, pastaj të Evropës ku ka koloni shqiptare, e më parë edhe të Egjiptit, të Stambollit, kjo e fundit me rëndësi të madhe sidomos për periudhën osmane deri në vitin 1912.

- Pastaj Arkivat e Gjermanisë (Berlinit), Anglisë (Londrës), Austrisë (Vjenës), Francës (Parisit), të cilat mbajnë një pjesë të madhe të dokumenteve për historinë e shqiptarëve e në veçanti edhe të Kosovës, pasi shumë herë fati i shqiptarëve në shekujt 19 dhe 20 u përcaktua nëpër këto qendra të mëdha botërore.

- Arkivat dhe bibliotekat e Shqipërisë (Tiranë), të cilat janë shumë të pasura në burime dhe materiale të ndryshme.

- Pastaj arkivat e Serbisë (Beograd), me të cilat duhet të kihet kujdes nga këndvështrimi i besueshmërisë, pasi mund të ketë falsifikim dhe mbishkrim të dokumenteve origjinale.

- Institucionet publike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në të kaluarën lidhur me fatin e shqiptarëve, e në veçanti me zhvillimet e fundit të shekullit të kaluar dhe fillimit të këtij shekulli në raport me Kosovën.

Biblioteka digjitale kombëtare do të jetë e suksesshme nëse do të mund të lidhte bashkëpunime me këto institucione. Bashkëpunimi i këtillë është mëse i domosdoshëm për shkak të historisë së Kosovës nëpër periudha të ndryshme dhe të historisë dhe kulturës shqiptare në përgjithësi. Meqë Shqipëria dhe shqiptarët në përgjithësi, e pastaj edhe Kosova, sidomos, pas Luftës së Dytë Botërore, nëse do të mund t'i bënim një veçim të këtillë, kanë kaluar dhe bashkëjetuar me popuj të tjerë nëpër shekuj të ndryshëm vjen natyrshëm në kohët e sotme edhe bashkëpunimi që institucionet tona kulturore të bashkëpunojnë me institucionet e tjera botërore me qëllim të ofrimit të një pasqyre sa më objektive të historisë, kulturës, identitetit, zhvillimeve të gjithmbarshme shqiptare dhe në veçanti lidhur me Kosovën. Pra, një bashkëpunim i tillë mund të themi se nuk është opsional, por i nevojshëm dhe i domosdoshëm me qendrat e ish-perandorisë romake, osmane, pastaj Versajë, Paris, Berlin, Londër, Rambuje, e shumë e shumë qendra të tjera.

Në punimin vijues, që do të botohet në numrin e ardhshëm të revistës, do të sjellim informacione, shtjellime dhe interpretime më të shumta të analizave të bëra në lidhje me pritshmërinë e përdoruesve aktualë dhe potencialë të bibliotekave në Kosovë.

Click here: www.portalialbanologjik.net

Liridon ZEKAJ

Në numrin e kaluar të revistës së Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, "Biblioletra", derisa disenjoja portalin albanologjik Shqipëri - Kosovë, dikur, në orët e vona të një mbrëmjeje, pata shkruar për bibliotekën digjitale, për të ardhmen e bibliotekës si dhe për sfidat e tashme dhe të ardhme të saj, të cilat presin t'i godasin edhe më tutje disa departamente të BKUK-së. Mirëpo, edhe atëherë, edhe sot, falë aftësimit të stafit të bibliotekës dhe angazhimit të drejtorit të saj, dr. Sali Bashota, është nisur t'u dilet ballë disa prej sfidave të ardhshme të saj, të cilat janë duke u realizuar me punë konkrete dhe në hap me bibliotekat e shteteve fqinje në disa departamente të saj, në të cilët ka qenë i domosdoshëm edhe intervenimi "elektronik".

Ndoshta për ndokënd mund të duket punë e vogël, por edhe në Shqipëri, gjithashtu edhe në Kosovë, portali albanologjik Shqipëri - Kosovë është pritur jashtëzakonisht mirë. Është konsideruar edhe dritare, edhe derë, edhe rrugë, edhe autostradë e shkëmbimeve kulturore, të cilën vazhdimisht po përpiqemi jo ta restaurojmë, por ta stolisim me tabela e informacione të reja (degëzime), fusha e nënfusha; ta bëjmë edhe atë një rrugë elektronike të kombit.

Kur u përurua portali, e të cilin e përuruam, pas Kosovës, edhe në Shqipëri, bashkë me një delegacion nga BKUK-ja, nuk di cili televizion nga Shqipëria mungonte atë ditë aty e i cili nuk i kushtoi mbi pesë minuta kronikë asaj ngjarjeje kulturore, të cilën tash, po e quaj me fjalët e disa medieve të Shqipërisë, titrat e temave të të cilave i lexoja poshtë në ekran derisa drekonim, ne një pjesë e stafit të BKUK-së dhe BKSH-së, në një restorant në Durrës: Përurimi i portalit albanologjik, ngjarje e madhe kulturore. Dhe, dorën në zemër, sido që t'i marrim ato fjalë miradije e sido që ta presim, edhe sot, një muaj e sa pas përurimit, atë ngjarje kulturore, portali albanologjik ka shtuar bashkëpunimin edhe bibliotekar edhe kulturor ndërmjet dy bibliotekave, të cilat janë partnere në këtë portal.

Megjithatë, kjo ngjarje, edhe shumë të tjera sikurse kjo, mbesin në ndërgjegjen e medieve të shkruara e elektronike të përcillen e të shkruhen për to. Kurse unë në këtë rast, si disenjator i asaj faqe, do ta përshkruaj punën e portalit albanologjik qysh në fillim të tij.

Para se t'ia filloja disenjimit të këtij portali, në muajin mars të 2011-s, prof. dr. Aurel Plasari, drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe prof. dr. Sali Bashota, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në Tiranë patën nënshkruar marrëveshjen për krijimin e portalit albanologjik Shqipëri - Kosovë, i cili,

pra, m'u besua mua ta disenjoja e t'ia jepja këtë formë, e cila duket se ngjason me ato të uebfaqeve të gazetave ose të shtëpive mediale por, jo sikurse ato, s'i ka ato rubrika të informacioneve.

Portali albanologjik Shqipëri - Kosovë, sikundër edhe është para Kosovës emri i Shqipërisë, edhe në portal logoja e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, bashkë me flamurin kombëtar, është vendosur në anën e majtë, kurse logoja e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, bashkë me flamurin shtetëror, është vendosur në anën e djathtë, ndërsa mes tyre janë mbishkrimi dhe linku i portalit albanologjik.

Në uebfaqen e portalit janë shtatë fusha: Rreth portalit, Hyrje të reja, Biblioteka digjitale, Këndi i albanologëve, Botime, Ngjarje dhe Kontakte. Brenda këtyre fushave ka edhe nënfusha. Fusha e parë, Rreth portalit, ka katër nënfusha: historiku, misioni, partnerë, dokumente. E dyta, Hyrje të reja, ka pesë nënfusha: libra, harta, doreshkrime, artikuj, periodikë. E treta, Biblioteka digjitale, ka pesë nënfusha: e-Albanica, antikuarë, doreshkrime, harta, periodikë. E katërta, Këndi i albanologëve, nuk ka asnjë nënfushë, mirëpo në të ardhmen pritet të degëzohet me nënfusha, kurse ka mjaft të dhëna për albanologë të huaj. E pesta, Botime, ka një nënfushë, e quajtur bibliografi, në të cilën në të ardhmen do të futet materiali bibliografik "Bibliografia Libri shqip 1944-1999", por edhe tekste të tjera bibliografike të hartuara nga punonjësit e institucioneve partnere. E gjashta, Ngjarje, nuk ka asnjë nënfushë, mirëpo janë futur e do të futen informacione nga aktivitetet e ndryshme vjetore që organizojnë bibliotekat. E, në fushën e fundit, të shtatën, Kontakte, përpos që lexuesit ose shfletuesit e këtij uebi mund të njihen me portalin albanologjik, mund edhe të dërgojnë e kërkojnë ndihmë për librat që ka bib-



lioteka në fondin e vet, gjithashtu edhe për projektet e bibliotekës rreth këtij portali, në e-mailin: mbeshtesni-@portalialbanologjik.net.

Së këndejmi, sado që do të avancohet e të mbushet ky portal me materiale të ndryshme, portali albanologjik është shërbim pa pagesë, që ofron informacion të larmishëm për shqiptarët, ku vend të veçantë zënë burimet bibliografike dhe koleksionet e digjituara të trashëgimisë kulturore kombëtare. Nëpërmjet tij mundësohet kërkimi dhe qasja në vlerat e rralla të trashëgimisë kombëtare në çdo kohë, nga kudo dhe nga kushdo. Pra, uebsajti ofron shërbime, si: të dhëna rreth historikut të krijimit të portalit; informacion për botime albanologjike, albanologë, hyrje të reja (libra, artikuj, periodikë) në të dy bibliotekat gjegjëse; qasje në burime të kombinuara digjitale dhe jodigjitale, burime bibliografike e informacione të tjera. Portali albanologjik do të zgjerohet shumë, ndërsa që ne do të jemi dëshmitarë të një zgjerimi dinamik të informacionit në këtë portal, që nënkupton pasurimin në forma të sistemimit e të shenjimit dhe 'afrimin' e kulturës albanologjike te një rreth i gjerë përdoruesish kulturor.

REFERENCA BIBLIOGRAFIKE NË FORMË TË ARTIKULLIT

Mr. Sc. Tahir FONIQI

Pjesë e këtij punimi janë një numër i referencave bibliografike të formës së artikujve, të vjela në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni, me të cilat dëshirojmë t'u vijmë në ndihmë përdoruesve që kanë interesime për kërkim në fushë të bibliografive të modifikuara për autorë e fusha të caktuara.

Bibliografia (e veprës letrare të Mirko Gashit) 1972-1988.- Hartuar nga T. Foniqi. Botohet në "Rilindja", 05.11.1988, f. 12. Ka 6 tituj të librave: botime, ribotime e përkthime. Fillon me titullin poetik "Në vorbullën e ujit" dhe përfundon me titullin "Libreto za genitiv vode" në përkthim të autorit të librit, Mirko Gashit. Hartohet mbi baza kronologjike.

Bibliografia. - Hartuar nga Ibrahim Rugova. Ndahet në tri pjesë: I. Bibliografi përshkruese e librit 1861-1944; II. Bibliografi komentuese e kritikës në shtypin shqiptar 1883-1944, III. Lista e organeve të shtypit 1848-1944. Në pjesën e parë jepen informacione për letërsinë tonë të traditës të botuar gjatë periudhës 1861-1944. Fillon me librin: "Girolamo De Rada, Principii di estetica", Napoli, 1861 e përfundon me titullin: Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti "Kritika letrare", Prishtinë, 1979. Kjo pjesë përfshin 18 tituj të librave, bashkë me ribotime. Ndërsa në pjesën e dytë gjejmë shënime të kritikës në shtypin e traditës, që nga "Fiamuri Arbërit", 1883 deri te "Revista letrare", 1944. Pjesa e tretë jep listën e organeve të shtypit, të traditës sonë, gjatë viteve 1848-1944. Teksti i përket bibliografisë së kryqëzuar.

Bibliografia. - Hartuar nga Ymer Jaka. Botohet në librin "Lidhjet letrare shqiptaro-frënge", Prishtinë, 1979, f. 181-185. Ka 76 njësi bibliografike. Fillon me njësinë "Bardha de Témal. Scènes de la vie albanaise" e përfundon me shkrimin "Le grand Castriotto d'Albanie. Histoire". Teksti është hartuar mbi bazën në autor dhe i përket bibliografisë elementare.

Bibliografia. - Hartuar nga Sefedin Fetiu. Është botuar në librin "Vepra e Migjenit dhe kritika e saj" të Sefedin Fetiut, Prishtinë, 1984, f. 149-[160]. Përfshin 327 njësi bibliografike: botime e ribotime. Teksti është ndarë në tri pjesë: a) Përmbledhjet (11 njësi); b) Artikuj, studime dhe shkrime të ndryshme për Migjenin (200); c) Literatura e përgjithshme (96). Teksti fillon me njësinë 'Migjeni-Vargjet e lira" e përfundon me shkrimin "Književno stvaralaštvo i povijest društva". Bibliografia është hartuar mbi bazën në autor.

Bibliografia. - Hartuar nga Rexhep Qosja. Botohet në studimin "Asdreni, Jeta dhe vepra" të R. Qosjes, Prishtinë, 1972, f. 338-[341]. Përfshin 118 njësi të ndara në gjashtë pjesë: Përmbledhjet (7 njësi), Vjersha të botuara në revista dhe gazeta (të përfshira në përmbledhjet) (25), Vjersha të pabotuara (50), Artikuj dhe proza të botuara (29), Artikuj dhe proza të pabotuara (4) dhe Proza të përkthyera (3). Teksti bibliografik fillon me njësinë "Reze Djelli. Vjersha lirike" e përfundon me "Gjyqi për hijen e gomarit". Teksti i përket bibliografisë elementare.

Bibliografia: Vëllimet me tregime humoristiko-satirike.- Hartuar nga Ramiz Kelmendi. Botohet në librin e tij "Tregimi ynë humoristiko-satirik (1944-1974)", Prishtinë, 1975, f. 121-[124]. Përfshin 51 njësi, të botuara në Tiranë e Prishtinë. Teksti fillon me "Stuhi në sirtarë: Tregime humoristike" të Tasim S. Aliajt e përfundon me librin "Talush Efendia" të Ramë Zukës (Zekeria Rexhës). Teksti i përket bibliografisë elementare.

Bibliografia. - Hartuar nga Agim Deva. Është botuar në librin "Poezia për fëmijë (1872-1980)", Prishtinë, 1982, f. 523-548. Përmban 589 njësi bibliografike , libra, të botuara në Tiranë, Sofje, Athinë, Shkup, Ferizaj etj. Fillon me njësinë: "Abavetar Arbëror", "Zër i Arbërisë", Athinë, 1882 e përfundon me njësinë e Gjergj Zhejit "Përralla e princeshës së dhjetë", në librin: "Çupa e trëndafilave", NSHB, Tiranë, 1957, f. 25-41. Librat janë botuar nga shtëpitë botuese: "Naim Frashëri", "Fatosi", Drejtoria e Botimeve Shkollore etj. të Tiranës, Rilindja e "Mustafa Bakija" të Prishtinës, "Zër i Arbërisë" të Athinës, "Vitosha" të Sofjes, "Flaka e vëllazërimit" e "Nova Makedonija" të Shkupit etj. Ky tekst është hartuar mbi bazën alfabetike të autorëve. I përket bibliografisë elementare.

Bibliografia e veprave letrare të Anton Pashkut 1961-1986. - Hartuar nga Tahir Foniqi më 1986. Është botuar në "Rilindja", 31.10.1987, f. 13. Përmban 14 njësi bibliografike për të rritur, bashkë me ribotime, përmbledhje-zgjedhje veprash, përkthime e komplete veprash. Fillon me vëllimin "Tregime", botuar në revistën letrare "Jeta e re", Prishtinë, 1961 e përfundon me kompletin e veprave, titulluar "Vepra", botuar nga Rilindja, Redaksia e botimeve e Prishtinës më 1986. Kompleti ka tre tituj: romanin "Oh","Tregime fantastike" dhe dramat "Tragjedi moderne". Bibliografia është hartuar mbi bazën kronologjisë, përkatësisht renditjes alfabetike brenda viteve dhe i përket bibliografisë primare.

Bibliografia e punimeve të botuara në revistën "Gjurmime albanologjike-Folklor dhe etnologji" I-X (1971-1980). - Hartuar nga Emine Fetahu. Botohet më 1982. Materiali bibli-

ografik përfshin 211 zëra bibliografikë dhe ndahet në gjashtë njësi tematike: I. Studime dhe artikuj (Etudes et articles), II. Materiale (Materiaux), III. Kritika dhe recensione (Critiques et comptes-rendus), IV. Bibliografi (Bibliographie), V. Kronika shkencore (Chronique scientifique), VI. Artikuj përkujtimorë.

Teksti fillon me njësinë e Lorenc Antonit "Trajtat polifonike të muzikës popullore vokale në Jugosllavi" e përfundon me artikullin e Hasan Kaleshit "Profesor Dr. Alois Schmaus (1901-1970). Teksti i përket bibliografisë elementare.

Bibliografia e Lidhjes së Prizrenit në periodikun e Shqipërisë 1948-1977. - Hartuar nga Shkëlzen Raça. Botohet në revistën "Përparimi", Prishtinë, 1978, 4, f. [564]-570. Përmban 60 njësi bibliografike. Fillon me tekstin "Burime të reja vendase mbi periudhën e Lidhjes së Prizrenit" e përfundon me shkrimin "Naim Frashëri mendimtar i shquar shqiptar". Teksti është ndërtuar mbi bazën në autor dhe i përket bibliografisë elementare.

Bibliografia e punimeve të Kadri Halimit. - Hartuar nga Drita Halimi-Statovci. Teksti ka 146 njësi bibliografike të ndara në 13 tërësi: I. Studime (trajtesa) e artikuj, II. Vështrime shkencore, III. Përmbledhje këngësh popullore, IV. Artikuj shkencorë-popullarizues, V. Artikuj e ndihmesa profesionale, VI. Kontribute shkencore dhe materiale, VII. Shënime shkencore, VIII. Lëndë etnografike, IX. Lëndë dialektologjike, X. Diskutime (polemikë) shkencore, XI. Nekrologji (In memoriam), XII. Kritika dhe recensione, XIII. Kontribute bibliografike. Teksti bibliografik fillon me studimin "O savremenoj narodnoj poeziji Kosova" e përfundon me shkrimin "Etnološka gradja u asopisu "Përparimi". Teksti i përket bibliografisë së anotuar.

Bibliografia e Shtjefën Gjeçovit-Kryeziut. - Hartuar nga Ramiz Kelmendi. Është botuar në kompletin e veprave të Shtjefën Gjeçovit, Libri 3, Prishtinë, 1985, f. 257-277. Teksti ka 201 njësi bibliografike, të ndara në katër kaptina: I. Veprat origjinale të Shtjefën Gjeçovit: A. Veprat e botuara, B. Dorëshkrime të Shtjefën Gjeçovit (67 njësi), II. Përkthimet e Shtjefën Gjeçovit: A. Veprat e botuara, B. Mbetur në dorëshkrim (6), III. Literatura për Shtjefën Gjeçovin (112), IV. Nga letërkëmbimi i Shtjefën Gjeçovit (16). Teksti fillon me njësinë bibliografike "Kanuni i Lék Dukagjinit ner Malcina t'Mdhaa" e përfundon me njësinë "Letra të shumta". Teksti i përket bibliografisë kronologjike.

Bibliografia e poezisë së sotme shqipe 29.XI.1944-1980. - Hartuar nga Agim Vinca. Është botuar në librin "Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980)", Prishtinë, 1985, f. 435-471. Përfshin 748 njësi bibliografike, bashkë me titujt: zgjedhje poezish, panorama e antologji. Teksti bibliografik fillon me titullin "Epopeja e Ballit Kombëtar" të Shefqet Musarajt (Buburicka), Tiranë 1944 e përfundon me librin poetik të Moikom Zeqos "Brenda vetes", Prishtinë, 1974. Njësitë bibliografike janë regjistruar mbi bazën alfabetike të autorëve. Teksti i përket bibliografisë elementare.

Bibliografia kronologjike e shkrimeve mbi krijimtarinë e tij [Naim Frashërit]. - Hartuar nga Rexhep Qosja. Botohet në "Porosia e madhe" të këtij autori më 1986, f. 579-[593]. Fillon me njësinë "Istori e Skënderbeut. (Shënim i shkurtër)" e përfundon me shkrimin e Jorgo Bulos "Një takim i rrallë me Abdyl Frashërin. Një fakt me vlerë për Naim Frashërin në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit". Teksti i përket bibliografisë elementare.

Bibliografia e veprave letrare të Adem Gajtanit 1961-1985. - Hartuar Tahir Foniqi më 1985. Është botuar në "Rilindja", 12.09.1987, f. 13. Ka 27 zëra bibliografikë, bashkë me përmbledhje-zgjedhje poezish, komplete veprash e përkthime. Fillon me vëllimin e poezive për të rritur "Drita në zemër", botuar në Prishtinë më 1961 e përfundon me njësinë e përkthyer në maqedonishte "Lebedovata pesna", botuar nga "Kultura" e Shkupit më 1982. Njësitë bibliografike janë regjistruar mbi baza kronologjike, përkatësisht alfabetike brenda viteve. Teksti i përket bibliografisë primare.

Bibliografia e veprave letrare të Josip Relës 1962-1983.- Hartuar nga Tahir Foniqi. Botohet në "Rilindja", 14.05.1988, f. 12-13. Përmban 13 njësi bibliografike, bashkë me ribotime, përmbledhje veprash e përkthime. Fillon me njësinë teatrore "Lundërza e Jozhës", botuar nga "Jeta e re" më 1962 e përfundon me dramën "Nita", botuar më 1968 nga "Bagdala" e Krushevcit. Njësitë bibliografike janë hartuar mbi bazën kronologjike. Teksti anon kah bibliografia e kryqëzuar.

Bibliografia e veprave letrare të Hivzi Sulejmanit 1958-1984. - Hartuar nga Tahir Foniqi më 1984. Botohet në "Rilindja", 24.01.1987, f. 14. Ka 22 njësi bibliografike, bashkë me ribotimet e përkthimet. Fillon me pjesën teatrore "Miu në xhep", botuar nga revista "Jeta e re" më 1958 e përfundon me njësinë "Deca moje reke", në përkthim të autorit, botuar nga "Narodna Knjiga" e Beogradit më 1976. Njësitë janë regjistruar mbi bazën kronologjike, përkatësisht alfabetike brenda viteve. Teksti anon kah bibliografia e kryqëzuar.

Bibliografia e veprave letrare të Rexhai Surroit 1959-1986. - Hartuar nga Tahir Foniqi. Botohet në "Jeta e Re", 1989. nr. 2, f. 183-184. Përmban 8 njësi bibliografike, bashkë me ribotimet. Fillon me romanin "Besniku", botuar në Prishtinë më 1959 e përfundon me romanin "Orteku", botuar nga shtëpia botuese "Naim Frashëri" e Tiranës më 1986. Teksti është hartuar mbi baza kronologjike të viteve dhe i përket bibliografisë primare.

Bibliografi. - Hartuar nga Floresha Dado, si shtojcë të librit të saj "A.Z. Çajupi - Jeta dhe vepra", Prishtinë, 1986, f. 255-259. Përmban 69 njësi bibliografike të ndara në tri tërësi: I. Bibliografi e veprave të Çajupit, II. Literatura kryesore, III. Studime mbi Çajupin. Teksti bibliografik fillon me njësinë "Baba Tomorri, Vjersha prej A. Z. Chajup", Ndë Kairo, 1902 dhe përfundon me njësinë e Gj. Zhejit: " A.

Zako Çajupi -"Jeta dhe vepra", T. 1986, f. 95. Teksti i përket bibliografisë indikative.

Bibliografi. - Hartuar nga Rexhep Ismajli. Botohet në librin "Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbërit (1706)", Prishtinë, 1985, f. 257- [265]. Fillon me njësinë "Disa veçori fonetike që ka e folmja e Gjakovës" të Hilmi Aganit e përfundon me njësinë "Weinrich, Harald, Le temps". Teksti është hartuar mbi bazën në autor.

Bibliografi (I. Veprat origjinale të Shtjefën Gjeçovit). - Hartuar Ruzhdi Mata. Është botuar në librin e këtij autori me titull "Gjeçovi nderi i kombit", Tiranë, 2000, f. 191-198. Teksti anon kah bibliografia e anotuar.

Bibliografi e botimeve të letërsisë botërore në gjuhën shqipe në Jugosllavi 1948-1982. - Hartuar nga Engjëll Sedaj. Botohet në "Rilindja" të datës 26.03.1983, f. 14. Përfshin 120 libra zhanresh të ndryshme. Teksti është ndarë në gjashtë njësi: I. Letërsia antike greko-romake, II. Letërsia frënge, III. Letërsia ruse, IV. Letërsia angleze, V. Letërsia gjermane, VI. Letërsia italiane, spanjolle dhe letërsitë tjera. Fillon me njësinë "Bretkocat" të Aristofanit, Prishtinë 1968 e përfundon me librin "Njeriu i kohës sime" të Salvatore Kuasimodo. Teksti i përket bibliografisë elementare.

Bibliografi e fragmenteve të studimit Rimbaud në Jugosllavi, të botuar në periodik. - Hartuar nga Mensur Raifi. Botohet në librin "Polemika letrare", Prishtinë, 1981, f. 129-130. Përmban 20 njësi bibliografike. Fillon me njësinë "Receptiviteti dhe situimi letrar i një poeti" e përfundon me punimin "Nuk mund të mohohet koekzistenca e metodave të ndryshme në kritikën letrare". Teksti i përket bibliografisë elementare.

Bibliografi e krijimeve të Ndre Mjedës e për Ndre Mjedën në Kosovë 1948-dhjetor 2007. – Hartuar nga Tahir Foniqi më 2007. Botohet në librin: Tahir Foniqi, Kërkime bibliografike", Prishtinë, 2008, f. 26-37. Teksti bibliografik është ndarë në tri pjesë: I. Veprat, II. Poezia dhe III. Të tjerët për Ndre Mjedën. Pjesa e parë përfshin njëmbëdhjetë vepra letrare të Mjedës e një të Mark Gurakuqit, të botuara në Kosovë, mes viteve 1962-2005. Pjesa e dytë përfshin 72 poezi të Mjedës, të botuara në botimet periodike e në tekstet shkollore, mes viteve 1948-1986, ndërkaq pjesën e tretë ngërthen 33 punime për Mjedën e veprën e tij letrare, të botuara mes viteve 1959-2007. Bibliografia është hartuar mbi bazën alfabetike të autorëve dhe i përket bibliografisë selektive. Kjo është bibliografia e parë për Ndre Mjedën në Kosovë.

Bibliografi e leksikografisë shqiptare (1947-1983). - Hartuar nga Ibrahim Goçi. Është botuar më 1984 në revistën "Gjuha shqipe", Prishtinë, 1984, nr. 1, f. [50]-57. Përmban 52 njësi bibliografike. Teksti bibliografik fillon me njësinë "Fjalor serbokroatisht-shqip : srpskohrvatsko-albanski jezik", Tiranë, 1947 e përfundon me fjalorin e Frang Bardhit "Fjalor latinisht-shqip, Prishtinë 1983. Teksti i përket bibliografisë kronologjike.

Bibliografi e materialeve të botuara në revistën "Gjurmime albanologjke - Folklor dhe etnologji" I-X.- Hartuar nga Emine Fetahu. Është botuar në Gjurmime albanologjike -Folklor dhe etnologji, XII-1982, Prishtinë, 1982, f. [251]-278. Përmban 574 zëra bibliografikë. Fillon me njësinë: "Ca të dhëna mbi ritet e motmotit në fshatin Arangjell të Kërçovës", të autorit Shaziman Adili e përfundon me krijimin gojor "Zhabalina zhaba", kënduar prej Shefki Behlulit e shënuar nga Kadri Kadriu. Teksti i përket bibliografisë elementare.

Bibliografi e plotë e veprave të A. Martinesë. - Hartuar nga Rexhep Ismajli. Botohet në librin "Elemente të gjuhësisë së përgjithshme" të A. Martinesë, Prishtinë, 1983, f. 281-[300]. Teksti përmban 302 njësi dhe ndahet në tri pjesë: Libra - 19 njësi; Artikuj - 166 njësi; dhe Recensione, parathënie, intervista, vërejtje 117 njësi. Fillon me njësinë "La geminacion consonnantique d'origine expressive fans les langues germanique" e përfundon me njësinë "Intervistë dhënë J.P. Gibiat". Teksti është hartuar mbi bazën kronologjike dhe anon kah bibliografia anotuese.

Bibliografi e romanit bashkëkohor shqiptar 1949-1986. - Hartuar nga Ibrahim Rugova. Botohet më 1987. Përmban 321 zëra bibliografikë romanesh, të botuar në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e në diasporën shqiptare. Fillon me titullin "Çlirimtarët I" të Dhimitër S. Shuteriqit, Tiranë, 1952 e përfundon me librin "Shija e bukës mrume" të Martin Camajt, Romë, 1958. Teksti i përket bibliografisë kronologjike.

Bibliografi e romanit shqiptar për fëmijë në Jugosllavi 1959-1982. – Hartuar nga Anton Berisha. Është botuar më 1983 në gazetën "Rilindja". Përfshin 32 romane, bashkë me dy romanet, botuar në vazhdime në "Rilindja" 1981-1982: "Cuci" të Avdi Shalës e "Mysafiri i nënstrehës sime" të Ragip Ramës. Teksti fillon me romanin "Lugjet e verdha" të Rexhep Hoxhës, Prishtinë 1959 e përfundon me romanin e Ragip Ramës "Mysafiri i nënstrehës sime", Prishtinë 1982. Këtu përfshihen romanet për fëmijë të Rexhep Hoxhës, Sinan Hasanit, Rifat Kukajt, Maksut Shehut, Vehbi Kikajt, Qamil Batallit, Agim Devës, Ibrahim Kadriut, Rushit Ramabajës, Abdyl Bunjakut, Ymer Shkrelit, Lutfi Rusit, Avdi Shalës e Ragip Ramës. Ky tekst i përket bibliografisë elementare.

Bibliografi e shkrimeve kritike për romanet e shkrimtarit Nazmi Rrahmani. - Hartuar nga Sabri Hamiti. Botohet në librin "A-ZH Romanet e Nazmi Rrahmanit, Prishtinë, 1982, f. 144-[147]. Përmban 29 njësi bibliografike. Fillon me shkrimin e Isak Ahmetit "Toka e përgjakur" dhe "Tërësia e jetës" e përfundon me shkrimin e Agim Vincës "Drejt romanit social-psikologjik". Teksti i përket bibliografisë elementare.

Bibliografi e veprave të shkrimtarit Nazmi Rrahmani. - Hartuar nga Sabri Hamiti. Botohet në librin "A-ZH Romanet e Nazmi Rrahmanit, Prishtinë, 1982, f. 139-[143]. Përmban 46 njësi

të ndara në dy grupe: a). Romanet (15 njësi, bashkë me ribotimet e një përkthim në gjuhën serbokroatishte), b). Tregime, Fragmente (31). Teksti fillon me njësinë "Malësorja" e përfundon me fragmentin "Bija e lëshueme". Teksti i përket bibliografisë elementare.

Bibliografi e veprave letrare të Azem Shkrelit 1960 - 1986. - Hartuar nga Tahir Foniqi më 1986. Është botuar në gazetën "Rilindja" të Prishtinës më 20.08.1988, f. 13. Përmban 24 njësi bibliografike për të rritur, bashkë me ribotimet, përmbledhje-zgjedhje poezish dhe përkthimet. Fillon me përmbledhjen e poezive "Bulzat", botuar në Prishtinë më 1960 e përfundon me librin "Ljudze i cini", botuar në Novi Sad më 1985. Njësitë bibliografike janë regjistruar mbi bazën kronologjike dhe i përket bibliografisë primare.

Bibliografi e veprave të Eqrem Çabejt 1929-1976. - Botohet më 1988, në Studime gjuhësore. Libri 5, f. 349-358. Fillon me njësinë "Poezia e Lasgush Poradecit", Gazeta e Re, nr. 22.2 e përfundon me titullin "Disa aspekte të kulturës popullore shqiptare në vështrim gjuhësor", "Studime filologjike" XXXI (XIV), nr. 2, f. 11-12. Hartohet mbi bazën kronologjike.

Bibliografi e veprës letrare të Mark Krasniqit. - Hartuar nga Tahir Foniqi. Botohet në librin: Tahir Foniqi, "Kërkime bibliografike", Prishtinë, 2008, f. 40-46. Përmban 29 njësi bibliografike: botime, ribotime e përmbledhje-zgjedhje poezish. Fillon me njësinë 'Prrallat e gjyshit', Prishtinë, 1953 e përfundon me titullin "Vjersha të zgjedhura për fëmijë", Prishtinë. 2003. Bibliografia është hartuar mbi bazën alfabetike dhe i përket bibliografisë retrospektive.

Bibliografi e veprës letrare të Musa Ramadanit 1969-2000. - Hartuar nga Tahir Foniqi. Botuar në librin "Kërkime bibliografike", Prishtinë, 2008, f. 75-80. Bibliografia ka 19 tituj: botime, ribotime e përmbledhje-zgjedhje veprash. Fillon me titullin "Mëkatet e Adamit" e përfundon me njësinë "Nostalgji antike". Bibliografia është

hartuar mbi bazën alfabetike dhe i përket bibliografisë kronologjike.

Bibliografi kronologjike e shkrimeve mbi Fan S. Nolin dhe revolucionin e vitit 1924. - Hartuar nga Mensur Raifi. Botohet në librin "Lasgushi, Noli, Migjeni", Prishtinë, 1986, f. 137-145. Përmban 147 njësi të botuara në Prishtinë, Tiranë, Shkup, Palermo, Zhenevë, Londër etj. Teksti fillon me njësinë Papas Gaetano Petrrota, "Popolo Lingua e letteratura albanese" e përfundon me studimin e Rexhep Qosjes "Fan Noli dhe modeli kritik i kulturës shqiptare". Bibliografia është hartuar mbi bazën kronologjike dhe i përket bibliografisë elementare.

Bibliografi kronologjike e shkrimeve mbi Lasgush Poradecin. - Hartuar nga Mensur Raifi. Botohet në librin "Lasgushi, Noli, Migjeni", Prishtinë, 1986, f. 133-135. Përmban 47 njësi. Fillon me njësinë "Dy fjalë mbi vjershëtorin Lasgush Poradecin" (Anonim) e përfundon me shkrimin "Testamenti poetik i Lasgushit" nga Sabri Hamiti. Teksti i përket bibliografisë kronologjike.

Bibliografi kronologjike e shkrimeve mbi Migjenin dhe vitet letrare të 30-ta. – Hartuar nga Mensur Raifi. Botohet në librin "Lasgushi, Noli, Migjeni", Prishtinë, 1986, f. 147-159. Përmban 226 njësi të botuara në Tiranë, Korçë, Vlorë, Prishtinë, Shkup, Milano, Romë, Beograd, Shkodër, Mynhen e Leningrad. Teksti fillon me njësinë "Horizonte të reja për letërsinë kombëtare" të autorit Nonda Bulka e përfundon me punimin "Poezia e Migjenit, realiteti dhe krijimtaria e viteve "30" nga Ramazan Vozga. Bibliografia është hartuar mbi bazën kronologjike dhe i përket bibliografisë elementare.

Bibliografi kronologjike selektive e dramës pas Luftës së Dytë Botërore (1948-2008).- Hartuar nga Besim Rexhaj. Botohet në librin "Drama Shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, 1948-2008, vëllimi i dytë, f. 337-340. Përfshin 92 drama apo vëllime dramash. Fillon me dramën "Prefekti" të Besim Levonjës, Tiranë, 1948 e përfundon me vëllimin "Drama", Pejë, 2008. Teksti është hartuar mbi bazën kronologjike.

Bibliografi publikimesh në gjuhën shqipe në Kosovë e Metohi 1944-1958 [I-XIII]. -Hartuar nga Ali Rexha. Është botuar, në vazhdime, mes viteve 1959-1961, në revistën shkencore "Përparimi" të Prishtinës. Teksti i përket bibliografisë kronologjike.

Bibliografi retrospektive e shtypit periodik shqiptar e mbi Shqipërinë e vjetëve 1848-1944 [pesë vazhdime]. - Hartuar nga Palok Daka. Është botuar në revistën shkencore "Përparimi"të Prishtinës gjatë viteve 1972 e 1973. Përf-

shin 345 njësi bibliografike. Fillon me njësinë "L'Albanese d'Italia [Shqiptari i Italisë] e përfundon me "Bisedimet e Parlamentit". Ky periodik është botuar në Napol, Prizren, Prishtinë, Palermo, Bukuresht, Shkodër, Kozencë, Londër, Sofje, Romë, Bruksel, Kajro, Beograd, Gjenevë, Boston, Trieshtë, Selanik, Stamboll, Korçë, Durrës, Vlorë, Vjenë, Tiranë, Gjirokastër etj. Teksti i përket bibliografisë kronologjike.

Bibliografija Kosovsko Metohijske Oblasti. - Hartuar nga T. P. Vukanoviq. Është botuar në revistën "Glasnik Muzeja Kosova i Metohije" në shtatë vazhdime 1956-1965. Botohet në Prishtinë më 1961. Teksti është mbi bazën në autor dhe i përket bibliografisë analitike.

Bibliografik bilgiler. - Hartuar nga Ibrahim Rugova. Është botuar në librin "Yugoslavya çagdas arnavut siiri antalojisi", Prishtinë, 1979, f. 251-253. Teksti jep shënime për jetën dhe veprën letrare të 18 poetëve tanë, nisur nga Esad Mekuli deri te Sabri Hamiti. I përket bibliografisë elementare.

Botime për Skënderbeun në shek. XV, XVI, I. – Hartuar nga Jup Kastrati. Është botuar në Shkodër në botimin serik "Buletin Shkencor", 1967, nr. 6, f. [71]-88. Përfshin punime të autorëve shqiptarë e të huaj. Mbështetet në 96 referenca dhe i përket bibliografisë analitike.

"Çevren" dergisinin on yillik Bibliografiyasi. - Hartuar nga Enver Baki. Është botuar më 1984. Përfshin rreth 1122 njësi bibliografike: poezi, prozë, kritikë letrare, studime të ndryshme etj. Teksti anon kah bibliografia indikative.

Etnologija u asopisu "Përparimi". - Hartuar nga Nahire Kabashi. Është botuar në "Glasnik Muzeja Kosova i Metohija", Libri I, Prishtinë, 1956, f. [447]-448. Përfshin lëndën etnologjike të revistës "Përparimi", botuar gjatë vitit 1955. Teksti është hartuar mbi bazën në autor dhe anon kah bibliografia e anotuar.

Etnološka gradja u asopisu "Jeta e re". - Hartuar nga Kadri Halimi. Botohet në "Glasnik Etnografskog muzeja u Beogradu", Libri XVIII, Beograd, 1955, f. 265-270. Përfshin 42 njësi bibliografike. Teksti fillon me njësinë: "Folklori muzikuer në Kosovë e Metohi" të Lorenc Antonit e përfundon me "Kash e lasha", shënuar nga Ndue Nekaj. Teksti i përket bibliografisë analitike.

Etnološka gradja u asopisu "Përparimi".- Hartuar nga Kadri Halimi. Botohet në "Glasnik Muzeja Kosova i Metohije", II, Prishtinë, 1957, f. 331-[337]. Titujt e njësive bibliografike janë dhënë në gjuhën shqipe. Teksti i përket bibliografisë analitike.

Hivzi Sulejmani - bibliografi e veprave dhe e kritikës. - Hartuar nga Ibrahim Rugova. Botuar në "Jeta e re", 1975, f. 565-578. Bibliografia përmban 114 njësi dhe ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë fillon me romanin "Njerëzit", Prishtinë, 1966 e përfundon me artikullin "Vjershënimi sipas modës dhe trillit". Ndërsa pjesa e dytë fillon me njësinë "Rrjedha dhe gjenerata në prozën tonë" të Ali Aliut dhe përfundon me poezinë e Ymer Shkrelit "Vdekja u ngjit deri në Shkronjën H.". Teksti ka parathëni edhe është hartuar me bazë alfabetike.

Kolana e veprës letrare të Sabri Hamitit.- Hartuar Tahir Foniqi. Botohet në librin: Tahir Foniqi: "Kërkime bibliografike", Prishtinë, 2008, f. 100-101. Ka dhjetë njësi bibliografike. Fillon me njësinë "Poezi" e përfundon me librin: "Letësia bashkëkohore". I përket bibliografike së kryqëzuar.

Kolana letrare e Ibrahim Rugovës. - Hartuar nga T. Foniqi. Botohet në librin: Tahir Foniqi, "Kërkime bibliografike", Prishtinë, 2008, f. 99-100. Ka tetë njësi bibliografike. Fillon me njësinë "Prekje lirike" e përfundon me titullin "Refuzimi estetik". I përket bibliografisë së kryqëzuar.

Kolana letrare e Sterjo Spasses. – Hartuar nga T. Foniqi. Botohet në librin: Tahir Foniqi, "Kërkime bibliografike", Prishtinë, 2008, f. 99. Ka tetë njësi bibliografike. Fillon me romanin "Pse?" e përfundon me njësinë "Sokolesha e tregime të tjera". I përket bibliografisë së kryqëzuar.

Kolana romaneske e Nazmi Rrahmanit. - Hartuar nga T. Foniqi. Botohet në librin: Tahir Foniqi, "Kërkime bibliografike", Prishtinë, 2008, f. 100. Ka gjashtë njësi bibliografike. Fillon me romanin "Malësorja" dhe përfundon me njësinë: Sabri Hamiti, "A-ZH Romanet e Nazmi Rrahmanit. I përket bibliografisë së kryqëzuar.

Kronologjia e romanit për fëmijë. - Hartuar nga Agim Deva. Është botuar më 1977 në Prishtinë, në librin "Romani ynë për fëmijë", f. 523-548. Përmban 20 njësi bibliografike. Fillon me romanin "Lugjet e verdha" të Rexhep Hoxhës, Prishtinë 1959 e përfundon me titullin "Rrasa e zogut" të Rifat Kukajt, Prishtinë, 1975. Teksti i përket bibliografisë elementare.

Kronologji e poezisë shqipe në Jugosllavi (1945-1979) : (Bibliografi e plotë). – Hartuar nga Ibrahim Rugova. Është botuar në librin "Strategjia e kuptimit", Prishtinë, 1980, f. 274-286. Përfshin 232 njësi bibliografike, bashkë me ribotimet e titujt: përmbledhje-zgjedhje poezish. Bibliografia fillon me librin "Nji fyell ndër male" të Martin Camajt, Prishtinë 1953 e përfundon me titullin "Pengu i dashurisë" të Enver Gjerqekut, Prishtinë 1978. Teksti është hartuar mbi bazën kronologjike.

Kronologji e romaneve të Nazmi Rrahmanit 1965-1986. - Hartuar nga Tahir Foniqi. Është botuar në gazetën "Rilindja", 11.04.1987, f. 13. Përmban 20 njësi bibliografike, bashkë me ribotimet e përkthimet. Fillon me romanin "Malësorja', botuar nga Rilindja e Prishtinës më 1965 e përfundon me romanin "Posle smrti', botuar nga Jedinstvo e Prishtinës më 1980 në përkthim të Ratomir Markoviqit. I përket bibliografisë kronologjike.

Kronologji e veprave letrare të Enver Gjerqekut 1957-1984. - Hartuar nga Tahir Foniqi. Është botuar në "Rilindja", më 23.05.1987, f. 13. Ka 20 zëra bibliografikë, bashkë me ribotimet në gjuhën serbokroatishte e sllovenishte. Fillon me vëllimin poetik "Gjurmat e jetës", Prishtinë 1957 e përfundon me librin "Pjesme", Sarajevë 1984, në përgatitje të Iso Kolaçit, në përkthim të autorit. Librat janë përkthyer nga: Esad

Mekuli, Enver Gjerqeku, Hasan Mekulit, Tone Pavqek etj. Bibliografia është hartuar mbi bazën kronologjike.

Kronologji e veprave letrare të Esad Mekulit 1955-1985. - Hartuar nga Tahir Foniqi Botohet në "Rilindja", 10.01.1987, f. 14-15. Përmban 17 njësi bibliografike, bashkë me ribotimet e përkthimet në gjuhën serbokroatishte e turqishte. Teksti fillon me vëllimin poetik "Për ty", botuar nga "Mustafa Bakija" e Prishtinës më 1955 e mbaron me librin "Brigjet", botimi i dytë, botuar në Prishtinë më 1985. Teksti i përket bibliografisë kronologjike.

Kronologji e veprave letrare të Rrahman Dedajt 1962-1986. - Hartuar nga Tahir Foniqi. Është botuar në "Rilindja", 08.08.1987, f. 12. Përmban 31 njësi të veprave letrare për fëmijë e të rritur, bashkë me ribotimet, përmbledhjet-zgjedhje letrare dhe përkthimet. Fillon me vëllimin e poezive për të rritur "Me sy kange", botuar nga "Jeta e re" në Prishtinë më 1962 e përfundon me librin e përkthyer në gjuhën turqishte "Sali günü=e martë, botuar më 1984 nga "Milliyet" e Stambollit në përkthim të Hasan Merxhanit. Teksti i përket bibliografisë kronologjike.

Kronologji e veprave letrare të Tajar Hatipit 1962-1985. - Hartuar nga Tahir Foniqi. Është botuar në "Rilindja", 21.03.1987, f. 13. Përmban 16 tituj të veprave për fëmijë e të rritur, bashkë me ribotimet e një përkthim. Fillon me vëllimin e tregimeve për fëmijë "Rrethimi", Prishtinë 1962 e përfundon me librin turqisht "Hikâyeler", botuar nga "Nova Makedonija" e Shkupit më 1969 në përkthim të Hasan Merxhanit. I përket bibliografisë kronologjike.

Kronologji e veprave të Vehbi Kikajt 1963-1984. - Hartuar nga Tahir Foniqi. Botohet në "Rilindja", 04.07.1987, f. 13. Përfshin 18 tituj të veprave letrare për fëmijë: poezi e prozë, bashkë me ribotimet e përkthimet. Fillon me librin e poezive "Gurrat", Prishtinë 1963 e përfundon me "Prodavnica rosa", botuar nga Jedinstvo e Prishtinës më 1984 në përkthim të Serbolub Tasiqit. Librat i kanë botuar Rilindja, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës, Jedinstvo dhe Lidhja e të Verbërve të Kosovës, "Nasha Knjiga" e "Detska Radost" (Shkup) dhe "Zmajeve deçje" e Novi Sadit. Teksti anon kah bibliografia primare.

Lingvistika i etnologija u asopisu "Jeta e re". - Hartuar nga Kadri Halimi. Botohet në "Glasnik Muzeja Kosova i Metohije", Libri I, Prishtinë, 1956, f. [339]-445. Ky tekst bibliografik është ndarë në dy pjesë: I. Lingvistika dhe II. Etnologija. Në pjesën e parë janë përfshirë punimet gjuhësore të Zekeria Rexhës, Hasan Kaleshit, Kasim Domit, etj. Ndërkaq, në pjesën e dytë, botohen punime etnologjike të Lorenc Antonit, Kadri Halimit, Ndue Lekajt, Xhafer Batushës, Haxhi Krasniqit, etj. Teksti fillon me njësinë: "Dy fjalë mbi prishjen e gjuhës" të Zekeria Rexhës e përfundon me punimin e Vehap Shitës: "Mbi letërsinë gojore të shqiptarëve të Kosovës e Metohisë". Njësitë bibliografike janë dhënë paralel: në gjuhën shqipe e serbokroatishte. Teksti i përket bibliografisë analitike.

Rimbaud në gjuhën shqipe (Bibliografi). - Hartuar nga Mensur Raifi. Është botuar në librin "Polemika letrare", Prishtinë, 1981, f. 118-[120]. Përfshin 24 njësi bibliografike: Artikuj (8), Përkthime (15), Në një botim të veçantë (1). Fillon me njësinë "Artyr Rembo (shënim)" të Mensur Raifit e përfundon me shkrimin "Mbi letërsinë e kulturën (kapitulli) Pol Verleni dhe dekadentët". Teksti i përket bibliografisë elementare.

Romani shqiptar në Jugosllavi (Bibliografi). - Hartuar nga Ibrahim Rugova. Botohet në gazetën "Rilindja", më 28.08.1982, f. 14. Ka 61 tituj romanesh për të rritur: Hivzi Sulejmani, Sinan Hasani, Rexhai Surroi, Azem Shkreli, Rexhep Zogaj, Nazmi Rrahmani, etj. Bibliografia fillon me romanin "Njerzit" të Hivzi Sulejmanit, botuar në revistën letrare "Jeta e re", botim në vazhdime gjatë vitit 1951 e përfundon me romanin "I treti" të Halil Kajtazit, Prishtinë, 1979. Teksti i përket bibliografisë elementare.

Shënime bibliografike. - Botohet në librin: Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, "Kritika Letrare", Prishtinë, 1979, f. 471-[485]. Teksti bibliografik jep shënime për 16 shkrimtarë e gjuhëtarë tanë: Jeronim De Rada, Naim Halit Frashëri, Faik Konica, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Asdreni, Fan Noli, Krist Maloki, Eqrem Çabej, Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Skënder Luarasi, Mitrush Kuteli, Lasgush Poradeci, Dhimitër S. Shuteriqi, Migjeni. Teksti i përket bibliografisë deskriptive (përshkruese).

Shkrime mbi Fan S. Nolin dhe Revolucionin e 1924. - Hartuar nga Mensur Raifi. Është botuar në librin "Fan S. Noli dhe Migjeni", Prishtinë, 1979, f. 118-[121]. Ka 28 njësi. Fillon me njësinë "Ndikimi i Revolucionit të Qershorit në veprën e Fan S. Nolit" të Adriatik Kalullit e përfundon me shkrimin e Xhevat Lloshit "Përpunimi gjuhësor i "Historisë së Skënderbeut" nga Fan S. Noli". Teksti është hartuar mbi bazën e kriterit alfabetik dhe i përket bibliografisë elementare.

Shkrime mbi Migjenin. - Hartuar nga Mensur Raifi. Është botuar në librin "Fan S. Noli dhe Migjeni", Prishtinë, 1979, f. 176-[179]. Ka [53] njësi bibliografike. Fillon me njësinë "Poeti si frymëzim artistik : mbi dramën e Ton Shoshit, Migjeni" e përfundon me poezinë e Rrahman Dedajt kushtuar Migjenit me titull "Migjenit in baladë e fshehur". Teksti i përket bibliografisë elementare.

"Tan yayinlari". - Botohet në gazetën turke "Tan" të Prishtinës, më 1984. Përfshin 42 njësi bibliografike. Fillon me titullin "Yaliznik Merdiveni" të poetit Bajram Ibrahim e përfundon me librin "Sevil" të Iskender Musbeg. Teksti i përket bibliografisë elementare.

Vepra letrare e Ali Podrimjes : Bibliografia 1961-1988. - Hartuar nga Tahir Foniqi. Botohet në "Fjala", 1989, nr. 5-6, f. 5. Përfshin 35 tituj: botime, ribotime, përmbledhje-zgjedhje e përkthime. Fillon me librin: Thirrje, 1961 e përfundon me titullin e përkthyer: Ngugtalan k , 1987. Teksti është hartuar mbi bazën kronologjike.

BIBLIOTEKA NDËRKOMUNALE "FAN S. NOLI"

(NJË HISTORIK I SHKURT)

Shefki OSMANI,

Drejtor i bibliotekës "Fan S. Noli" në Gjilan

Biblioteka "Fan S. Noli" në Gjilan, në historinë e saj të zhvillimit, është zhvendosur disa herë nga një vend në tjetrin, ashtu siç edhe është ndërruar statusi dhe titulli i saj në kohë e kontekste të ndryshme.

Me kalimin e kohës kjo bibliotekë ka pasur rëniet dhe ngritjet, sa i përket zhvillimit të veprimtarisë bibliotekare.

Sipas të dhënave të mëhershme, sallat e leximit ekzistonin që nga viti 1909. Këto salla të hapura, kishin funksion të shumëfishtë, duke u organizuar edhe aktivitetet me karakter kulturor e arsimor.

Sipas disa shënimeve, në fillim të shek. XX, në Kozanë të Gjilanit, ekzistonin mini-biblioteka të institucioneve fetare, shkollore ose biblioteka private të personave kulturëdashës.

Fondet librare në këto biblioteka pasqyronin nivelin intelektual të kohës, dëshirat dhe prirjet e tyre. Mund të pohohet lirisht se këto fonde ishin bërthamat e para të burimeve të informacionit edhe për bibliotekën publike në Gjilan.

Për bibliotekën e Gjilanit, si dhe për bibliotekat e tjera në Anamoravë ka shumë pak të dhëna. Me funksionimin e ihtadijeve, ruzhdieve si dhe medresesë, për herë të dytë në vitin 1937 kemi biblioteka me një fond të librave islame, në rend të parë: Kur'an, hadithe dhe filozofi islame.

Biblioteka "Fan S. Noli" në Gjilan

Një bibliotekë të tillë ka pasur teqeja Sadi në Gjilan (muhaxhirmahallë).

Për themelimin e bibliotekës në Gjilan, më 30 gusht 1938, kontribut kanë dhënë edhe pjesëtarët e "Shoqatës së gjilanasve", anëtarë të së cilës ishin edhe: Ramush Osmani, Ramiz Ahmeti, Kamber Ferati, Alush Ahmeti, Nexhip Bejtullahu etj.

Kushtet për punë normale në fillim ishin tejet të vështira dhe të kufizuara. Furnizimin me libra në biblioteka e bënin shoqëritë patriotike shqiptare, si nga brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Klubi "Bashkimi" i Manastirit, atëbotë ishte ndër bazat më të rëndësishme prej nga furnizoheshin qytetet e Vilajetit të Kosovës, me tekste shkollore dhe me literaturë të nevojshme në gjuhën shqipe.

Pas Luftës së Dytë Botërore, biblioteka ka vepruar në kuadër të Shtëpisë së Kulturës. Gjerë në vitin 1955, për shkak të rrethanave diskriminuese në dëm të shqiptarëve, në fondin e bibliotekës kishte një numër të vogël të librave në gjuhën shqipe dhe në atë turke. Librat kryesisht ishin në gjuhën serbe, arabe dhe osmane.

Biblioteka "Fan S. Noli" para luftës (1999) kishte 183000 vëllime librash të ndryshëm. Gjatë luftës është shkatërruar, është djegur e asgjësuar 1/3 e fondit të kësaj biblioteke.

Që nga viti 1990 regjimi serb shkatërroi çdo institucion në Kosovë. Edhe biblioteka e qytetit, tani ndërkomunale, si: "Fan S. Noli", në Gjilan, e kishte të njëjtin fat. Ajo një kohë të gjatë nuk u pasurua me fonde librare dhe nuk u mirëmbajt. Përkundrazi biblioteka ishte varfëruar, sepse fondi bibliotekar, inventari e pajisjet e tjera ishin plaçkitur.

Në këtë kohë, si edhe në të gjitha sferat e tjera të jetës, edhe në kuadër të

zhvillimit të bibliotekave, situata ishte e rëndë. Ushtrohej presion sistematik që shqiptarët t'i braktisnin vendet e punës, dhe kur këto masa presioni nuk dhanë rezultate, u ndërmorën masa për largim nga puna të bibliotekarëve shqiptarë me arsyetimin banal të "*tepricës teknologjike*" , kurse në vend të tyre pushteti i dhunshëm merrte në këto vende të punës, pjesëtarë të nacionaliteti serb pa kurrfarë kriteri. Më e rëndësishmja për atë kohë ishte të zbatohej politika diskriminuese në dëm të kuadrove shqiptare, që udhëhiqej nga pushteti serb.

Po të vështrohen me kujdes statistikat mbi gjendjen e kuadrit, si dhe pajisjen e bibliotekës me literaturë nga fusha të ndryshme të dijes për kohën në fjalë - vërehet qartazi se sa diskriminuese ishin këto masa për popullin shqiptar.

Dëmtim të madh pësuan edhe bibliotekat e fshatrave Përlepnicë, Zhegër, Cërrnicë, Malishevë, Dobërqan, Shurdhan, kurse ajo e fshatit Llashticë ishte djegur deri në themel.

Me angazhimin e të gjithë punonjësve të bibliotekës për një kohë të shkurtër, pas luftës, u arrit të rihapen biblioteka e reja në fshatin Llashticë dhe Miresh (ish-Dobëqan). Pastaj u rihapën edhe bibliotekat në Zhegër, Përlepnicë, Bresalc, Pasjan, Budrikë e Ulët, Partesh, dhe Koretishtë.

Edhe Biblioteka qendrore në Gjilan nisi të realizojë shumë projekte të rëndësishme. Në kuadër të bibliotekës qendrore, në vitin 2000 u hap Sektori shkencor, ndër të parët në Kosovë. Ndërsa në vitin 2002 u hap Sektori i Krijuesve të Vendlindjes, ku janë vendosur veprat e krijueseve të komunave: Gjilan, Dardanë, Viti, Artanë, Bujanoc, Preshevë dhe Kumanovë.

Biblioteka u ndihmua në forma të ndryshme nga shumë qytetarë, institucione shoqërore e private, shtëpi botuese, por edhe nga projekte e programe të institucione ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Lista e donatorëve të bibliotekës është e gjatë. Në shenjë mirënjohje e motivimi, për dhurues e përkrahës të librit e të bibliotekave, që nga viti 2001, biblioteka qendrore themeloi shpërblimin "*Miku i librit*".

Maketi i objektit të ri të Bibliotekës së Gjilanit

Biblioteka "Fan S. Noli", organizon Panairin e Librit, tani më tradicional. Sivjet organizohet panairi i librit i 39-ti me radhë.

Në bibliotekën e qytetit dhe në degë e saja, numri i të punësuarve ishte pothuajse minimal, ndërsa tani janë të inkuadruar 21 bibliotekarë e librarë me kualifikime përkatëse.

Në fund të vitit 2010, Biblioteka Ndërkomunale "Fan S. Noli", kishte 59414 tituj të librave apo 169546 ekzemplarë, prej tyre në gjuhën shqipe 101.694 ekzemplarë; në gjuhën angleze 3329; në gjuhën serbe 57.592; në gjuhën turke 3603; në gjuhë të tjera 3328 ekzemplarë.

Numri i lexuesve, i të gjitha moshave, është në rritje. Sa për ilustrim, nëse u referohemi të dhënave nga viti që e lamë pas (2010), kur biblioteka kishte gjithsej 4521anëtarë, prej tyre nxënës ishin 3971 anëtarë; studentë – 382; punëtorë - 135 anëtarë; bujq - 9 anëtarë, si dhe amvise - 24 anëtarë.

Numri i aktiviteteve kulturore po ashtu është në rritje të vazhdueshme. Në Bibliotekë Ndërkomunale "Fan S. Noli", organizohen ekspozita të librit, promovime të veprave të autorëve, takime me shkrimtarë, si dhe këshillime profesionale, vizita me karakter njohjeje e shkëmbim përvojash.

Meqenëse objekti i tanishëm është i pamjaftueshëm që t'i pranojë gjithë përdoruesit, me përkrahje të Komunës së Gjilanit, do të fillojë të ndërtohet biblioteka e re me një hapësirë prej 4000 m^2. Shpresojmë se ky objekt do të mund të përmbushë kërkesat e shtuara të përdoruesve të të gjitha profileve, duke mundësuar shërbime moderne në përputhje me standardet bashkëkohore të bibliotekarisë.

PERSPEKTIVAT KOMBËTARE NË INTEGRIMET BOTËRORE

(EDICIONI VI I KONFERENCËS KOMBËTARE TË BIBLIOTEKONOMISË)

18-19 nëntor 2011, Prishtinë

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë organizuan, më 18 - 19 nëntor 2011, organizuan në Prishtinë Edicionin VI të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë me temën "*Perspektivat kombëtare në integrimet botërore*".

Kjo konferencë, e cila tashmë është tradicionale, është organizim i përbashkët i këtyre dy institucioneve më të rëndësishme të bibliotekonomisë - të Kosovës dhe të Shqipërisë, i mbështetur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës dhe Ministria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve e Shqipërisë.

Dr. Sali Bashota, drejtori i BKUK-së, hapi zyrtarisht këtë konferencë, duke theksuar që dy bibliotekat kombëtare po e çelin portën e informacionit dhe komunikimit me botën dhe po ofrojnë shërbim cilësor për përdoruesit në në thesarin e tyre të çmuar kulturor. Ai tha se se Edicioni i gjashtë i Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, ka për synim kryesor trajtimin e perspektivës kombëtare të bibliotekave tona në integrimet botërore dhe uroi që gjatë kësaj konference të inicohen ide, tema e projekte, që hapin rrugë në rrjedhat dhe në zhvillimet që përkojnë me trendet më bashkëkohore të zhvillmit të bibliotekave.

Dr. Aurel Plasari, duke numëruar prurjet e reja të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, zuri në gojë edhe Portalin Albanologjik Shqipëri-Kosovë, si një sprovë promovuese që ka të bëj me prekjen e të gjitha strukturave të dokumentimit dhe të informimit të caktuara për të përmbushur nevojat e përdoruesve me interesim në fushën albanologjike. Ai pastaj, duke u lidhur me perspektivat e dy bibliotekave, të Shqipërisë e të Kosovës, foli për konceptin e ri të "bibliotekave hibride", si integrim i harmonishëm i dokumenteve letër me ato elektronike, në një bazë gjithnjë më të gjerë. Dr. Plasari theksoi se për nevojat e ngutshme të ndryshimeve në strukturën e shërbimeve të ofruara nga bibliotekat tona dhe këto ndryshime mund t'i kryejmë vetëm nëse identifikojmë, paraprakisht, barrierat që na pengojnë për zhvillimin e një "biblioteke hibride": barriera kulturore, organizative, strategjike, teknike dhe – afërmendsh – financiare.

Gjatë dy ditëve të konferencës, pati një sërë kumtesash e diskutimesh të rëndësishme rreth problemeve që lidhen me perspektivat e bibliotekave tona në integrimet botërore, si kumtesat e Etleva Domit "Aftësimi në informacion në mjedisin digjital: sfidë në mijëvjeçarin e ri"; Fazli Gajraku "Kosova: kujtesa, informacioni dhe relevanca"; Mimoza Shkodrani "Kërkesat funksionale për regjistrimet bibliografike"; Bukurije Haliti "Menaxhimi i i koleksioneve digjitale në katalogët e bibliotekave"; Izet Abdyli "Integrimi i kulturës kombëtare përmes bibliotekave dhe arkivave"; Ederina Demo "Trendet e shërbimit të referencave në përballje me zhvillimin e teknologjisë së informacionit"; Behije Luga & Enilda Kola "Digjitimi i koleksioneve të hartave të rralla"; Ramize Bajraktari "Libri shqipe në Kosovë midis integrimit kombëtar dhe globalizimit" dhe Ramush Zeka "Arsimimi në fushën e informacionit".

Me këtë Konferencë, eksperti nga Shqipëria - Ramazan Vozga, u paraqit me temën " Një paraqitje e Portalit Albanologjik Shqipëri - Kosovë", duke dhënë konceptet dhe përmbajtjet bazë të Portalit Albanologjik – projekt ky i përbashkët i dy bibliotekave kombëtare, ndërsa Liridon Zekaj, disenjator i këtij portali, bëri një prezantim të uebportalit, disenjit dhe navigimit të tij.

Në këtë konferencë, të gjashtën me radhë, u nxor një rezolutë nga BKUK dhe BKSH, ku u shprehet vullneti i të dy bibliotekave për intensifikim të bashkëpunimit dhe realizim të projekteve të përbashkëta, që janë në funksion të perspektivave kombëtare në integrimet dhe trendet botërore të bibliotekonomisë.

Bukurije HALITI

KOLEKSIONET E BIBLIOTEKËS NË EKRANIN TUAJ

(PROJEKT I FINANCUAR NGA AMBASADA AMERIKANE NË KOSOVË)

Fatime MEHMETAJ,

Biblioteka "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë

Pamje nga promovimi i projektit të financuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë

Biblioteka "Hivzi Sulejmani" e Prishtinës, përmes OJQ-së "Miqtë e Librit dhe Bibliotekës", në fund të muajit shtator ka fituar një donacion nga Ambasada Amerikane në Kosovë në vlerë 29,913.25 dollarë amerikan për realizimin e projektit Koleksionet e bibliotekës në ekranin tuaj (Library Collections@ Your Screen).

Përmes këtij projekti, përdoruesit e bibliotekës dhe të gjithë banorët e Prishtinës do të informohen më shpejt, më mirë dhe do të kenë qasje online në të gjitha materialet që posedon biblioteka. Duke siguruar shërbime online, katalog online, rezervime të librit online, regjistrimin online, si dhe qarkullimin më të shpejtë dhe më efektiv të shërbimeve. Si rrjedhojë, do të rritet interesimi për shfrytëzimin e koleksioneve të bibliotekës dhe shkëmbimit të informacionit.

Qëllimi i projektit Koleksionet e bibliotekës në ekranin tuaj, është:

- Aktivizimi i Modulit të qarkullimit të Programit Aleph në Bibliotekën "Hivzi Sulejmani";

- Përmirësimi i infrastrukturës së Programit Aleph 500 që funksionon në bibliotekë: Moduli i katalogimit; zbatimi i Modulit të qarkullimit dhe Ueb OPAC;

- Pajisja e shfrytëzuesve dhe e stafit në 5 degët e bibliotekës me Modulin e katalogimit dhe qarkullimit të koleksioneve për ta shpejtuar marrjen e informacioneve, huazimit dhe kthimit të tyre;

- Dhënia e kontributit për krijimin e katalogut unik të Kosovës që menaxhohet nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

Për realizimin këtij projekti parashihen 3 licenca të programit Aleph 500, 10 kompjuterë dhe 10 tavolina për 5 degët e bibliotekës për staf dhe për lexues, shërbimet dhe konsultimet për konfigurimin dhe modifikimin e Modulit të katalogimit dhe qarkullimit, krijimi i një udhëzuesi në gjuhën shqipe dhe trajnime intensive të stafit dhe të përdoruesve për përdorimin e shërbimeve të reja elektronike.

Projektin e ka përkrahur edhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, duke ofruar ndihmë profesionale, sallat për trajnime dhe nevoja të tjera.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Prishtinës, e mbështet realizimin këtij projekti shumë të rëndësishëm të iniciuar nga "Biblioteka "Hivzi Sulejmani"për modernizimin e shërbimeve për banorët e Prishtinës, duke premtuar mirëmbajtjen vjetore të licencave të sistemit bibliotekar.

Ndërsa, Biblioteka "Hivzi Sulejmani" do të bëjë maksimumin, duke vënë në dispozicion stafin, sallat për trajnime dhe mjetet të tjera teknike që projekti të realizohet ashtu siç është paraparë. Gjithashtu, drejtori i bibliotekës "Hivzi Sulejmani", Munish Hyseni, falënderon Ambasadën Amerikane në Kosovë për financimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm për përdoruesit e bibliotekës.

Në organizimin e përvitshëm të takimit tradicional të fundvitit për ndarjen e shpërblimeve për lexuesit më të dalluar, mirënjohjeve për ata që kanë ndihmuar bibliotekën, si dhe shpalljes së librave më të lexuara për vitin 2011, Biblioteka "Hivzi Sulejmani" e Prishtinës i ndau mirënjohje z. Paul Engelstad - zyrtar për çështje publike në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë - për avancimin e shërbimeve elektronike të Bibliotekës.

Realizimi i projektit "Koleksionet e Bibliotekës në ekranin tuaj" udhëhiqet dhe menaxhohet nga OJQ-ja "Miqtë e Librit dhe Bibliotekës" në bashkëpunim me personelin udhëheqës të Bibliotekës "Hivzi Sulejmani" të Prishtinës. Projekti realizohet në periudhën shtator 2011 - prill 2012.

BKUK PARTNERE NDËRKOMBËTARE PËRMES PROJEKTIT TEMPUS

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është përfituese sivjet e një projekti të financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të programit TEMPUS IV. Si institucioni më i lartë bibliotekar në vend, BKUK-ja bën përpjekje të vazhdueshme për bashkëpunim të gjerë ndërkombëtar me institucione bibliotekare të niveleve të ndryshme, por edhe me agjenci e organizata të ndryshme financiare. Në këtë kontekst, BKUK-ja iu bashkua një nisme prej trembëdhjetë partnerësh të udhëhequr nga Instituti për Teknologji të qytetit Limerick të Irlandës për të aplikuar në programin ambicioz dhe konkurrues të TEMPUS-it me projektin "Zhvillimi i një programi arsimor të informacionit për mësim gjatë gjithë jetës dhe ekonomi të dijes në vendet e Ballkanit perëndimor". Ky projekt u cilësua i kompletuar, përmbajtjesor dhe i qëndrueshëm nga Komisioni Evropian dhe si i tillë u shpërblye me një financim prej afro një milion a dyqind mijë eurosh, të cilat ndahen proporcionalisht mes partnerëve të projektit.

Projekti përfshin trembëdhjetë partnerë nga tetë vende evropiane, duke përfshirë Irlandën, Rumaninë, Greqinë, Shqipërinë, Kosovën, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi dhe Britaninë e Madhe.

Qëllimi akademik kryesor i projektit është krijimi i disa programeve arsimore të informacionit, duke përfshirë kurse, si: vlerësimi i informacionit, burimet e informacionit, strategjitë për kërkimin e informacionit, pastaj si të parashtrohet pyetja kërkimore, referencat, plagjiatura dhe e drejta e autorit.

Projekti ofron përvoja të rëndësishme edhe në këto fusha, siç janë: bërja e hulumtimit, analiza e informacioneve, etika e kërkimit, planifikimi në karrierë, shkathtësitë informative, etj. Gjithashtu, ky projekt mëton që t'i përzgjedhë disa prej tyre dhe t'i zyrtarizojë përmes zhvillimit të programeve të plota dhe integrimit të tyre në kurrikulën mësimore të universiteteve përkatëse, ose programet të licencohen nga ministritë përkatëse dhe të ofrohen si të tilla për kategori të ndryshme të studentëve e të qytetarëve.

Projekti ka edhe objektivat e tij të veçanta, që mund të përfshihen, si vijon: zhvillimin e programeve arsimore të informacionit për mësim gjatë gjithë jetës dhe përdorimin e tyre në plan programe, zhvillimin e moduleve elektronike dhe inovative të programeve arsimore të informacionit, harmonizimin e programeve arsimore të informacionit, forcimin e kapaciteteve të institucioneve të arsimit të lartë për planifikim strategjik dhe zbatim të programeve arsimore të informacionit në mënyrë që të formësohen shkathtësi të transferueshme për një ekonomi konkurruese, dinamike dhe të bazuar në dije, zhvillimin e rregulloreve dhe udhëzimeve për programet arsimore të informacionit, përhapjen e metodave për zhvillimin e programeve arsimore të informacionit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së tyre.

Projekti është i ndarë në pesë pako të ashtuquajtura pakoja e menaxhimit, e zhvillimit, e cilësisë, e përhapjes dhe e eksploatimit. Për realizimin e këtyre pakove janë krijuar pesë grupe të veçanta nga secili përfitues partnerë, të cilat kujdesen për realizimin e aspekteve të veçanta të projektit brenda secilës pako. Grupet u zyrtarizuan në takimin e parë që u realizua në qytetin Limerick të Irlandës prej 21-25 nëntor 2011, ku morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës. Ekipi i BKUK-së u udhëhoq nga drejtori i Bibliotekës, i shoqëruar nga dhjetë përfaqësues të tjerë në përbërje të bibliotekarë të profileve të ndryshme të BKUK-së dhe profesorëve të Universitetit të Prishtinës. Me këtë përbërje mendohet se do të bashkohet dija bibliotekare dhe akademike në realizimin sa më të mirë të projektit në fjalë. Në këtë takim u diskutuan çështje të ndryshme menaxheriale, organizative, administrative dhe akademike të projektit, pastaj rrjedha e aktiviteteve, takimeve të ardhshme, mënyra e komunikimit, mënyra e punës së grupeve, menaxhimi i grupeve punuese, rezultatet, raportet, programet e informacionit, etj. Projekti do të realizohet brenda një periudhe trevjeçare (2011-2014). Me zhvillimin e programeve dhe realizimin e këtij projekti, BKUK-ja do të jetë institucioni i parë bibliotekar në vend që ofron programe të strukturuara për mësim gjatë gjithë jetës.

Aktivitetet e deritanishme të BKUK-së për ofrimin e informacionit sa më afër lexuesit, si dhe ky projekt, dëshmojnë për përkushtimin e këtij institucioni për avancimin dhe përvetësimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e bibliotekarisë. Ajo do të përpiqet që informacioni të përhapet sa më shumë te të gjithë qytetarët e Kosovës në mënyrë që informacioni i shndërruar në dije të udhëheqë të gjitha aspektet shoqërore dhe ekonomike në vend.

Në fund, BKUK është falënderuese ndaj zyrës së TEMPUS-it në Kosovë, e cila ka ndihmuar BKUK-në në komunikim dhe lidhje me partnerë në këtë përpjekje të mirëseardhur për sistemin bibliotekar të vendit.

Diana TOPALLI

PREZANTOHET NË TIRANË PORTALI ALBANOLOGJIK SHQIPËRI-KOSOVË

Pas prezantimit para një muaji në Prishtinë, Portali Albanologjik Shqipëri – Kosovë, u prezantua më 19 dhjetor edhe në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (BKSh).

Në prani të z. Aldo Bumçi, ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të anëtarëve të Këshillit Shkencor dhe të Këshillit Administrativ të BKSh-së, të drejtuesve dhe specialistëve të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (BKUK) paraqitjen e portalit e bëri Prof. Dr. Aurel Plasari, drejtor i BKSh-së. Ai theksoi se pas nënshkrimit të marrëveshjes për ngritjen e Portalit të përbashkët Albanologjik Shqipëri - Kosovë, më në fund portali vihet në funksion. Ai falënderoi stafet e specialistëve të të dyja bibliotekave, në mënyrë të veçantë specialistët e Teknologjive të Reja në BKSh të drejtuar nga znj. Behije Luga, ata të Albano-Balkanologjisë të drejtuar nga znj. Afërdita Sharxhi, të Bibliografisë Kombëtare të drejtuar nga z. Maks Gjinaj, si dhe vuri në dukje punën e Dr. Etleva Domi, zv/drejtore e BKSh-së, për bashkërendimin me sukses të punës jo vetëm brenda kësaj biblioteke, por edhe midis të dyja palëve partnere të angazhuara në këtë projekt të madh e të rëndësishëm për shkencat albanologjike.

Z. Plasari bëri përshkrimin konkret të Portalit duke u ndalur fillimisht në historikun e përpjekjeve për ngritjen e tij dhe në misionin e tij, si dhe mënyrën e qasjes në rubrikat e tij. Ai u ndal në mënyrë të veçantë në bibliotekën digjitale e-Albanica me nëndarjet e saj (antikuarë, dorëshkrime, periodikë dhe harta), rubrikë që, me



burimet e saj albanologjike të digjituara, përbën thelbin e këtij zbatimi të rëndësishëm të teknologjisë së informacionit në bibliotekat shqiptare.

Në fjalën e tij Prof. Dr. Sali Bashota, drejtor i BKUK, u shpreh se ndihet i nderuar dhe i lumtur që merr pjesë në këtë përurim të Portalit në Tiranë. Ai vlerësoi lart bashkëpunimin institucional të të dyja bibliotekave tona kombëtare për ngritjen e Portalit Albanologjik që do t'u shërbejë të gjithë përdoruesve shqiptarë kudo që ata janë, si edhe të gjithë të interesuarve për vlerat dhe përkatësisht, informacionet albanologjike. Ai e vlerësoi portalin si arritje të përpjekjeve të përbashkëta për integrim në bibliotekën europiane dhe atë botërore.

Duke marrë fjalën në këtë veprimtari, z. Aldo Bumçi, ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, përgëzoi titullarët e të dyja bibliotekave për këtë nismë të rëndësishme. Ministria, nënvizoi ai, do ta mbështesë Portalin dhe çdo përpjekje tjetër të BKSh-së për t'u përfshirë në implementimin e teknologjisë digjitale në shërbimet bibliotekare. "Vetë kryeministri,- nënvizoi ai,- ka shpallur projektin e digjitimit. Ne do ta mbështesim Portalin sepse ai bashkon përdoruesit e informacionit albanologjik, ashtu si Interneti bashkon komunitetin e shqiptarëve kudo". Në fund u bënë pyetje që shprehnin interesimin e të pranishmëve për këtë zhvillim të ri në ecurinë e bibliotekave shqiptare.

Marrë në ueb-faqen e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë: http://www.bksh.al/Te%20reja_ngjarje65.html

PASUROHEN KOLEKSIONET E BKUK-së



Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, përveç pasurimit të fondeve përmes ekzemplarit të detyrueshëm dhe blerjes, muajt e fundit është pasuruar edhe me një mori librash e revistash, si dhe materialesh të tjera bibliotekare nga donatorë të ndryshëm nga Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zvicra dhe Gjermania.

Një prej donacioneve më të rëndësishme vjen nga koleksionistja e njohur e veprave të Skënderbeut, Patricia Nugee nga Anglia, e cila vite më parë i ka dhuruar BKUK-së librin me titull ,,Historia për jetën dhe bëmat e Skënderbeut, Princit të Epirotëve" nga Marin Barleti, përkthim nga latinishtja në gjermanishte i vitit 1533 që njëherësh është edhe libri më i vjetër në BKUK .

Koleksionistja e njohur znj. Nugee i ka dhuruar BKUK-së edhe një libër të rrallë në gjuhën angleze, botim i vitit 1656 me titull: ,,Nga jeta e fisnikëve grekë dhe romakë", i cili përmbledhë në vete historinë, filozofinë dhe mendimet e çmuara të personaliteteve të rëndësishme si filozofë, mendimtarë, shkencëtarë dhe burrështetas të periudhës antike deri në mesjetë. Vlen të përmendet se në këtë libër nga një kaptinë e veçantë u kushtohet Mbretit të Epirit - Pirros dhe Princit të Epirotëve - Gjergj Kastriotit - Skënderbeut.

Një donacion tjetër që ka rëndësi të veçantë, sidomos për zhvillimin e koleksioneve të librit universitar vjen nga Biblioteka Qendrore e Zvicrës (Zentralbibliothek Zürich), e cila ka dhuruar mbi 3000 tituj, ku përfshihen librat e 65 shtëpive botuese.

Librat dhe tekstet e tjera universitare janë kryesisht në gjuhët: gjermane, angleze, italiane, frënge, spanjolle etj. Librat janë të fushave të ndryshme, si: libra enciklopedikë, historia, letërsia, filozofia, shkencat politike etj. Pra, shumica prej tyre janë tituj që përkojnë me koleksionet universitare në fusha të ndryshme të shkencës.

Gjithashtu, të vlerës së veçantë janë edhe librat e dhuruar nga Anthony Mullings, Drejtor i Qendrës së Moralit dhe Mirëqenies së Ushtrisë Amerikane në Bondsteel dhe Renne Favors, Programere në Bondsteel, të cilët i kanë dhuruar BKUK-së libra nga fusha beletristikës, kryesisht romane në gjuhën angleze nga shkrimtarë të njohur anglezë dhe amerikanë. Një pjesë e fondit të këtyre librave është ndarë edhe për bibliotekën e Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës.

Po ashtu, përmes Iniciativës studentore shqiptaro-gjermane TASH, përkatësisht studentëve shqiptarë në Frankfurt, BKUK-së i është dhuruar një bibliotekë pedagogjike me mbi 4000 libra, kryesisht në gjuhën gjermane. Në ceremoninë e dorëzimit, pos përfaqësuesve të MASHT-it dhe BKUK-së, ishte prezent edhe z. Knoth, Leitnanti i lartë i KFOR-it gjerman. Për realizimin e këtij projekti kanë kontribuar Muhamet Idrizi, kryetar i Iniciativës Studentore Shqiptaro-Gjermane TASH dhe Mirlinda Mujezic, anëtare e kësaj Iniciative.

Duhet theksuar se ky donacion është mundësuar edhe me mbështetje të Ambasadës Gjermane në Prishtinë, si dhe nga Divizioni X i Komandantit të KFOR-it – Bühler, në Sigmaringen, i cili e bëri transportin e librave nga Gjermania në Kosovë. Kontribut të veçantë ka dhënë edhe komuniteti shqiptar i Kishës Katolike në Stuttgart në emër të Viktor Spaqit.

Librat janë kryesisht nga fusha e pedagogjisë, filozofisë dhe shkencave shoqërore.

Diana TOPALLI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MIDIS BKUK-së DHE BIBLIOTEKËS KOMBËTARE TË HUNGARISË

5 dhjetor 2011, Budapest

Biblioteka Kombëtare e Hungarisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës e nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Bibliotekën Kombëtare të Hungarisë. Marrëveshja u nënshkrua nga Dr.Sali Bashota dhe Dr. Andrea Sajo, dy drejtorët e institucioneve më të larta bibliotekare të dy shteteve.

Delegacioni nga Kosova gjatë qëndrimit në Budapest, fillimisht është pritur nga ambasadorja e Republikës së Kosovës Shkëndije Sherifi dhe bashkëpunëtorët e saj, të cilët kontribuan në realizimin së kësaj marrëveshjeje të bashkëpunimit.

Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Hungarisë ishte e pranishme edhe Shkëndije Sherifi, ambasadore e Republikës së Kosovës në Budapest, e cila në fjalën e saj përshëndetëse e theksoi rëndësinë e veçantë të kësaj marrëveshjeje në nivelin kulturor, duke theksuar se kjo është marrëveshja e parë që realizohet midis dy institucioneve shtetërore të Kosovës dhe Hungarisë.

Drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare të Hungarisë dr.Adrea Sajo, e vlerësoi lart nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy bibliotekave kombëtare, duke i dëshiruar mirëseardhje sa më të shpejtë BKUK-së në gjirin e asociacioneve më të rëndësishme europiane e më gjerë dhe me këtë rast shpehu gatishmërinë për përkrahje dhe mbështetje të përhershme.

Ndërkaq drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dr.Sali Bashota duke i vlerësuar lidhjet miqësore shqiptaro-hungareze, veçanërisht kontributin e albanologëve hungarezë për gjuhën, kulturën dhe historinë e shqiptarëve, ndër të tjera, tha se kjo marrëveshje do të hap një dritare të re në fushën e bashkëpunimit midis dy institucioneve më të larta bibliotekare të të dy shteteve. Drejtori i BKUK-së e përmendi faktin se Biblioteka Kombëtare e Hungarisë ka koleksione mjaft të pasura, sidomos për jetën dhe veprën e Skënderbeut, si dhe mjaft materiale të tjera bibliotekare, të cilat objekt trajtimi i kanë periudhat historike të shqiptarëve në Ballkan e më gjerë.

Marrëveshja e nënshkruar midis dy palëve parasheh bashkëpunimin e këtyre dy bibliotekave kombëtare në këto fusha: huazimet e koleksioneve , organizimin e ekspozitave, shkëmbimin reciprok të përvojave profesionale, të informacioneve dhe arritjeve shkencore në fushat e interesit të veçantë, shkëmbimin e specialistëve me qëllim të trajnimeve dhe aftësimit profesional, pastaj s hkëmbimin e përvojave në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe digjitalizimin e materialeve bibliotekare, ruajtjen dhe restaurimin e teknologjisë, rrjeteve elektronike.

Në këtë marrëveshje parashihet edhe pjesëmarrja e përbashkët në projekte ndërkombëtare, me qëllim të modernizimit të shërbimeve dhe të arritjes së cilësisë në informacionin global të bibliotekave evropiane e më gjerë.

Gjatë vizitës dyditore ambasadorja Shkëndije Sherifi dhe drejtori Sali Bashota u takuan me albanologun Krisztain Csaplar-Degovics, i cili i dhuroi BKUK-së librin e tij në gjuhën hungareze që për temë i ka ngjarjet në periudhën e Rilindjes kombëtare shqiptare.

Gjithashtu, vlen të përmendet edhe vizita në shtëpinë e albanologut të ndjerë hungarez Istvan Schutz , i cili ishte njëri ndër pjesëmarrësit më të rregullt në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare që organizohet në Prishtinë. Në takimin me Gergely Schutz , u bisedua për koleksionin e librave të albanologut të mirënjohur hungarez, si dhe për mundësinë e botimit të fjalorit voluminoz shqip-hungarisht, i cili është në dorëshkrim.

Diana TOPALLI

IN MEMORIAM
SANIJE MUQAJ - DAJÇI

Në këtë vjeshtë u nda herët, parakohshëm dhe papritur nga jeta punëtorja e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare e Kosovës Sanije Muqaj - Dajçi - njëra ndër punëtorët më të mira, që do të kujtohet përgjithmonë për punën, vullnetin dhe sharmin e saj.

Lajmi për vdekjen e saj të hershme, tronditi kolegët e saj, ndërsa për përdoruesit e në veçanti studentët, të cilëve u doli në ndihmë gjithherë - në kërkim të literaturës e të informacionit, ishte humbje e madhe.

U lind në Skenderaj më 08. 04. 1955 në një familje arsimdashëse, fisnike e bujare. Pas mbarimit të shkollimit fillor dhe të gjimnazit në Shkencat Natyrore, fillimisht do të punojë në Skenderaj, ndërsa nga viti 1982, do të nisë punën në Bibliotekën Popullore dhe Universitare të Kosovës (tash Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës) si librare në shërbimin me përdorues.

Ajo, përveçse një punëtore shumë e vyeshme, ishte, gjithashtu edhe një nënë e mire, bashkëshorte e mire, gjyshe e mire.

Te ajo gjeje çuditërisht ndjesinë dhe rrugëtimin e ëmbël për jetën, ndërsa që nuk iu dha mundësia ta jetojë të plotë jetën.

Sanija dha kontribut të jashtëzakonshëm që nga fillimet e punës së saj në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Përvoja e pasur dhe e gjatë e dija në komunikim me përdorues, e bëri atë personin më të dashur dhe më të respektuar të bibliotekës. Me mirësinë dhe dëlirësinë që rrezatonte, si dhe vullnetin dhe dijen për punë, ajo u bë e dashur dhe e respektuar nga breza të ndryshëm studentësh e përdoruesish.

SANIJE MUQAJ - DAJÇI
(1955 - 2011)

Ishte ndjenjë e këndshme të punoje dhe të komunikoje me të. Atë e njihnin të gjithë se si i vihej punës me gjithë shpirt e me hov, duke pasur përkushtimin dhe qasjen miqësore në komunikim me të tjerët.

Ajo rendte gjithë kohën për të jetuar për bukurinë e dashurinë e jetës, duke jetuar me adhurimin që kishte për mikpritjen - shoqërinë dhe miqtë. Për këtë kanë kujtime të paharruara familja e saj, miqtë, kolegët dhe studentët.

Emri i saj do të kujtohet me një respekt e përkushtim të veçantë, duke e ditur se gjithë energjinë e vet nuk e kurseu për t'u dalë në ndihmë përdoruesve shumë vjet me radhë, gjatë kohës sa punoi në bibliotekë.

Vdekja është gjithnjë e pranishme, por kur ajo është e parakohshme dhe merr njeriun e mirë e të hareshëm, të ngrohtë e miqësor - siç ishte Sanija, ajo është aq dhimbshme dhe e zymtë.

Të fuqishme dhe të vlefshme janë veprat dhe fjalët tuaja për ne.

Ti ke dhënë virtyte për të të thënë - faleminderit Sanije për të gjitha ato që na ke lënë kujtim.

Izet ABDYLI

SYLEJMAN PIREVA, BIBLIOTEKA PUBLIKE "HIVZI SULEJMANI" E PRISHTINËS (1945 - 2010), PRISHTINË, BIBLIOTEKA PUBLIKE "HIVZI SULEJMANI', 2011, 314 F.

Biblioteka Publike "Hivzi Sulejmani" e Prishtinës këtë vit nxori botimin monografik për këtë institucion, autor i së cilës është punonjësi dhe drejtuesi shumëvjeçar i kësaj biblioteke Sylejman Pireva.

Libri përfshin katër periudha të zhvillimit të kësaj biblioteke dhe është shtjelluar kryesisht sipas një rendi kronologjik të zhvillimit të veprimtarisë bibliotekare dhe kulturore të këtij institucioni në kohëzgjatje prej 65-vjetësh. Ndarja në periudha sa është logjike është edhe praktike, për faktin se vetë ngjarjet e ndodhura dhe rrethanat e krijuara i karakterizojnë dhe i bëjnë të dallueshme këto periudha.

Periudhat edhe pse përkojnë me emrat e udhëheqësve të këtij institucioni bibliotekar, janë të shenjueshme sidomos me ndryshimet dhe rrethanat e krijuara politike dhe historike nëpër të cilat ka kaluar Kosova dhe institucionet e saja kulturore.

Autori në këtë libër ka përfshirë fillimisht periudhën kur biblioteka ishte themeluar në vitin 1945, për të përfshirë më pastaj zhvillimet vijuese të saj deri më 1977. Këtu jepen me një gjuhë të qartë e informacion të saktë, në formë kronologjike, zhvillimet dhe proceset më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar kjo bibliotekë gjatë kësaj periudhe. Periudha e dytë përfshin vitet 1977 – 1992, në të cilën autori vë në pah zhvillime pozitive dhe të hovshme të bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në fushë të pasurimit të koleksioneve, përpunimit të tyre, rritjes së numrit të përdoruesve, si dhe të aktiviteteve me domen të gjerë kulturor e arsimor. Periudha e tretë që përfshin vitet 1992 – 1999, karakterizohet si etapë e përmbysjes së gjithë vlerave të arritura më parë, me fokus të veçantë rrënimin dhe nëpërkëmbjen e vlerave kulturore shqiptare nga pushteti i dhunshëm serb. Ndërsa periudhën e katërt - 1999 – 2010, autori e quan më të drejtë "rilindje të bibliotekës", gjatë së cilës kemi një rikonstruktim institucional të bibliotekës, duke përfshirë këtu edhe sfidat dhe synimet e kësaj biblioteke për të arritur zhvillimet bashkëkohore në këtë fushë.

Kjo monografie, që është e bazuar në burime origjinale të shumta, është një kontribut i çmueshëm për t'u njohur më gjerësisht me veprimtarinë e kësaj biblioteke, por edhe një ndihmesë e mirë për të gjithë ata që mëtojnë të merren kurdoherë me historikun dhe zhvillimet e këtij institucioni.

Libri ka 315 faqe, në të cilin është përfshirë edhe albumi fotografik.

Bukurije HALITI

MONOGRAFI ME HISTORIK: 65 VJET BIBLIOTEKARI, GJAKOVË, BIBLIOTEKA NDËRKOMUNALE "IBRAHIM RUGOVA", 2011, 223 F.



Biblioteka Ndërkomunale ,,Ibrahim Rugova" në Gjakovë botoi monografinë me titull:,,Monografi me historik - 65 vjet bibliotekari". Përmes kësaj monografie është pretenduar që të jepet një pasqyrë e punës dhe aktivitetit të Bibliotekës Ndërkomunale të Gjakovës mbi gjashtë dekada. Libri është ndarë në dhjetë kapituj dhe jep një informacion lidhur me zhvillimin e bibliotekarisë në komunën e Gjakovës, e në veçanti bëhet përpjekje për të dhënë një kronologji të zhvillimit të Bibliotekës Ndërkomunale të Gjakovës.

Vlen të përmendet se monografia pretendon të japë informacione më gjithëpërfshirëse për jetën kulturore e historike të Gjakovës, por edhe për zhvillimin e Bibliotekave në Gjakovë. Monografia synon të ofrojë informacion për historikun e zhvillimit të bibliotekës - nga koha e formimit të saj - më 1947 e deri të viti 2010.

Jepen të dhëna të rëndësishme për aktivitetet kulturore në bibliotekë, pasurimin e fondit bibliotekar nga donatorët, vënia e gurthemelit të bibliotekës së re, bashkëpunimin bibliotekar, shkollimin e kuadrit, etj.

Monografia përmban shënime dhe të dhëna me shifra lidhur me punën e bibliotekës, ku është shoqëruar edhe me tabela përkatëse të raporteve mbi gjendjen e bibliotekave shkollore të cilat janë nën administrimin e Bibliotekës Ndërkomunale. Monografia, gjithashtu, është e shoqëruar me fotografi nga ngjarje dhe aktivitete të ndryshme që janë realizuar në këtë bibliotekë dhe në bibliotekat e tjera të rajonit të Gjakovës.

Në këtë monografi jepet informacion i rëndësishëm për aspekte dhe forma të ndryshme të bashkëpunimit dhe të përkrahjes së kësaj biblioteke nga donatorë dhe institucione bibliotekare e në veçanti me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare te Kosovës.

Izet ABDYLI